



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primijseno Me/Dana: 21.06.2019

Nr. i organit Org. broj	Numri/broj	Shtetëse Prilog	Vlera Vrednoset
	01-060/01-663		



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit Nr. 03/L - 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28 / 15, Qershor 2008), dhe të Nenit 42 paragrafi 42.3 i Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, në Nenin 6 pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Nr 01-013/594, e datës: 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e -VI-, të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, që do të mbahet me datë: **26.06.2019 (e Mërkure)**, duke filluar në ora 10.00.

Mbledhja do të mbahet në zyrën e drejtorit të Drejtorisë për Administratë në objektin e Komunës së Vitisë. Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e KPF-së
2. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), 2020-2021.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregulloren mbi themelimin dhe strukturimi e asamblesë komunale të fëmijëve.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregulloren për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunale Miqësorë për fëmijë
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik propozim rregullore për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së subjekteve të biznesit në Komunën e Vitisë
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit vjetori të punës së Kuvendit komunal të Vitisë për vitin 2020.

Viti, më 20.06.2019

Me respekt !

Kryesuesi i Kuvendit
Naim Pira






REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO			
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA			
19-06-2019			
Nr. Organi Cilësor	Nr. Niveli	Shprehje e Kusht	Vlera Vendime
02-035/02-654			



Republika e Kosovës

Komuna e Vitisë

Bazuar në nenin 58 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare nr 28/2008), dhe nenit 50 shkronja I) të Statutit të Komunës së Vitisë me numër 013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë :

PROPOZIM VENDIM

PËR KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE (KAB) TË KOMUNËS SË VITISË 2020-2022

Neni 1

Kryetari i Komunës së Vitisë i propozon Kuvendit Komunal që të aprovoj Vendimin „KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE (KAB) E KOMUNËS SË VITISË 2020-2022 “

Duke u bazuar në QARKOREN Buxhetore 2020/01 të datës 15.05.2019 me nr 01/777 nga ministria e Financave ku paraqet bazën për hartimin e buxhetit për vitin 2020-2022.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij propozim vendimi është „KORNIZA AFATMESME BUXHETORE (KAB) E KOMUNËS SË VITISË 2020-2022 “ e hartuar nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim .

Neni 3

Për zbatimin e këtij propozim vendimi do të kujdeset Kryetari dhe Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë dhe e nënshkrimit nga ana e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vitisë.

PROPOZUES : KRYETARI I KOMUNËS

Sokol Haliti





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova



KORNIZA AFATMESME BUXHETORE (KAB) E KOMUNËS SË VITISË 2020-2022

Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim

2019

Përmbajtja

I. Hyrje

II. Deklarata e Komunës në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore

III. Korniza Fiskale

3.1 Korniza makroekonomike komunale

3.2 Tendenca e të hyrave komunale dhe parashikimet 2020-2022

3.3 Donatorët e jashtëm

3.4 Politikat e reja

3.3 Tendenca e shpenzimeve komunale dhe parashikimet 2020-2022

IV. Korniza e Përformancës së Shpenzimeve


I. Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore, KAB, është një dokument i cili përgatitet nga zyrtarët e administratës komunale dhe miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor. Gjithashtu, KAB, siguron mekanizmat e nevojshme, përmes të cilave, objektivat prioritare, të identifikuara në dokumentet strategjike të komunës, aty ku ekzistojnë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor.

Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2020/01 të lëshuar nga Ministria e Financave.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2020-2022 (KAB 2020-2022) paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti Vjetor për vitin 2020. Qëllimi kryesor i KASH-it është që të ofrojë një analizë të bazuar për të vendosur kështu bazën për planifikimet buxhetore për vitet që vijnë në përputhje me prioritetet strategjike të Qeverisë

Kornizës Afatmesme Buxhetore do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritarë të zhvillimit dhe identifikimin e prioritetëve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2020-2022. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB Komunale dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:



II. Deklarata e Komunës në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore

Komuna e Vitisë shtrihet në pjesën juglindore të Kosovës, rajoni i Anamoravës përafërsisht 40 km në jug të Prishtinës. Kufizohet me 5 komuna tjera (Gjilanin, Ferizajin, Kaçanikun dhe dy komuna të reja si Klllokotin e Parteshin dhe në jug me IRJM-në. Pozita gjeografike që ka i mundëson asaj lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit. Lumi Morava e Binçës kalon përmes luginës qendrore të Komunës ku krijon kushte më të favorshme për aktivitete bujqësore . Komuna e Vitisë ka gjithsej 39 fshatra. Sipas rezultateve preliminare të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, Komuna e Vitisë ka 46.987 banorë (regjistrimi i vitit 2011) 2.64 % e popullsisë në total, madhësia gjeografike 270, popullsia pakicë në komunë 258, (Qarkorja Buxhetore 2020-2022/01 faqe 11) të organizuar në 10,389 ekonomi familjare (sipas faturave të tatimit në pronë për vitin 2019 - marrë nga sektori i tatimit në pronë).

Komuna e Vitisë shtrihet në pjesën qendrore të fushëgropës së Moravës së Epërme përmes saj kalon lumi Morava e Binçës. Është e vendosur në një rrafshirë shumë pjellore, e përshtatshme për kultivimin e të gjitha bimëve bujqësore. Pas okupimit të trevave shqiptare (Kosovës) nga pushtuesit Osman, treva e Vitisë ishte pjesë e Nahisë së Moravës.


Gjatë Luftës së Parë Ballkanike (1912), sikur pjesët tjera të Kosovës, edhe Vitia me rrethinë okupohet nga Serbia, ndërsa gjatë Luftës së Parë Botërore okupohet nga Bullgaria, mandej në mes dy luftimeve botërore ishte nën okupimin e Jugosllavisë (1918-1941). Gjatë Luftës së Dytë Botërore ishte pjesë e zonës okupuese Bullgare , ndërsa në vjeshtë 1944 ripushtohet nga Jugosllavia komuniste. Vitia në vitin 1912 ishte shpallur komunë, ndërsa gjatë Mbretërisë Jugosllave ishte pjesë përbërse e Banonisë së Vardarit me qendër në Shkup. Në pikpamje administrative Vitia ishte komunë në vetë si pjesë e Qarkut të Gjilanit. Në vitin 1952 nga qarku i Gjilanit formohen tri rrethe: Gjilani, Vicia, Dardana. Ndërsa në vitin 1959, kur transformohen rrethet, Vitia shëndërrohet Komunë në vetë.

Vitia ka një sipërfaqe relativisht të rrafshet, një tokë mjaftë pjellore, sipërfaqe të konsiderueshme pyjore (si pjesa e Karadakut të Shkupit, me majën e Kopilaçës me një lartësi prej 1490 m , male këto që formojnë edhe kufirin natyror mes Kosovës dhe Maqedonisë), por edhe rrjedha të mjaftueshme të lumenjve (Morava e Binçës, Letnica etj.) Gjithashtu Vitia ka sasi të jo metaleve. Kjo komunë, me një sipërfaqe prej rreth 300 km², shtrihet në juglindje të Republikës së Kosovës. Nga magjistralla Prishtinë – Shkup, Vitinë e ndajnë vetëm 13 km rrugë. Me Prishtinën, lidhet me rrugë automobilistike në dy drejtime: përmes Ferizajt (55 km) dhe Gjilanit (67km).

Vitisë i nevojiten vetëm 13 km për t'u kyçur në hekurudhat e Kosovës, kurse deri në aeroportin e Prishtinës duhet kaluar 80 km. Me pikën kufitare me Maqedoninë, Hanin e Elezit, e ndajnë 37 km rrugë, me Shkupin 60 km, ndërsa me aeroportin e këtij qyteti 82 km.

Mbi 1,649 deri në fund të vitit 2018 dhe deri më datë 30.maj 2019 janë 70 biznese të reja do të thotë totali i bizneseve aktive në komunën e Vitisë është që operojnë është 1,719 . Bazuar në të dhënat e zyrës për regjistrim të bizneseve në Komunën e Vitisë, afërsisht merren me : veprimtari tregtare, 30% në sektorin e shërbimeve 39%, prodhuese 19% , ndërtimore 13%.

Komuna e Vitisë



Vizioni i mëposhtëm për Komunën Vitisë i definuar pas konsultimeve me akterët e rëndësishëm të jetës politike ekonomike e sociale në Komunë bazohet edhe në dokumentet afatmesme dhe afatgjata strategjike, që ka zhvilluar komuna sic janë:

1. Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2020-2022 të Qeverisë së Kosovës dhe prioriteteve bazë të saj, si dhe Qarkoret Buxhetore Komunale 2020/01 të lëshuar nga ministria e Financave të Qeverisë së Republikës së Kosovës;
2. Plani zhvillimor i Komunës së Vitisë dhe Kllokotit (tash Komunë e re) 2010-2020+
3. Plani zhvillimor urban – Viti 2010-2015+

Vizioni i Komunës për tri vitet e ardhshme është një vend me plan të zhvilluar komunal dhe urban, zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, dhe shërbime efikase e kualitative, i integruar në proceset rajonale dhe ndërkombëtare, si një qendër me kultura bujqësore , industri përpunuese (drurit, metaleve), e kulturës së pasur, arsimimit dhe jetës sportive, me shërbime financiare të zhvilluara dhe krijimit të kushteve më të mira të jetesës për qytetarët e saj.

Djep kulturor i shkollës shqipe, urë e zhvillimit të qëndrueshëm, modern, të fuqishëm, funksional me të gjitha përmbajtjet, komunë policentrike, atraktive për të jetuar dhe punuar, partneritetet publiko private do të determinojnë shërbimet cilësore, aktivitete ekonomike tregtare, industriale dhe turizëm në zhvillim, Komuna e Vitisë do jetë me të gjitha resurset atraktive për investime dhe ndërmarrësi, sidomos në industrinë përpunuese, agrobiznes, turizëm kulturor e rekreativ, me theks të veçantë në zhvillimin e qëndrueshëm, modern, të fuqishëm, funksional me të gjitha përmbajtjet, qytet kompaktë, atraktiv për të jetuar dhe punuar, promovues i partneritetet publiko private me shërbime cilësore, aktivitete ekonomike e mirëqenie në zhvillim, me rolin dhe identitetin e fuqizuar.

Atributet më të rëndësishme të çfarëdo dokumenti të planifikimit strategjik dhe vizionit të definuar janë së pari lehtësira e komunikimit si dhe së dyti llogaridhënia. Me qëllim të përmbushjes së këtyre dy attribute binjake prioritet

strategjike të Komunës në periudhën afatmesme janë grupuar në pesë prioritete që do të mundësojnë realizimin e qëllimit të vizionit tonë për Komunën.

Nga këto pesë prioritete kanë të bëjnë me realizimin e objektivave dhe kontribuon në zhvillimin e shërbimeve më të mira komunale për qytetarët e Komunës së Vitisë:

1. Forcimi i Ekonomisë Komunale me mundësi për të gjithë

Rritja e ekonomisë komunale përmes:

- Përmirësimi të standardeve të arsimit dhe nivelit të arritjes (pajisje shkollore, renovime shkollore dhe përmirësim, bursa për student, laboratore)
- Mbështetjes direkte të sektorit bujqësor dhe blegtorisë

2. Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve

Krijimi dhe ndihma për qytetarët për të pasur jetë të shëndetshme dhe aktive në komunitetin e tyre:

- Asistenca sociale për familjet në nevojë, pa të ardhura/të ardhura të ulëta
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile (Caritas Kosova)

3. Përmirësimi i ambientit të Komunës dhe qëndrueshmëria e tij

Absorbimi i popullatës në rritje në komunë dhe njëkohësisht mbrojtja e ambientit përmes:

- Përmirësimi dhe rigjenerimi të infrastrukturës rrugore (shenjëzimi i komunikacionit, ndriqimi publik dhe numerizimi), transportit, kanalizimit dhe ujit të pijshëm,
- Përmirësimi të standardeve ambientale,
- Ofrimi i më shumë hapësirave dekorative, parqeve,
- Promovimi i projekteve për rininë, sport dhe kulturë.

4. Krijimi i siguri për qytetarët e komunës

- Përmirësimi i siguri në qytet dhe në tërë territorin e komunës

Sepse komuna ka komitetin e siguri ku shqyrtohet në vazhdimësi situata e siguri

Ndërsa prioriteti i fundit strategjik i Komunës ka të bëjë me efikasitetin e brendshëm të qeverisë komunale dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët e saj.

5. Funksionalizimi i qeverisjes komunale që ofron shërbime efikase dhe që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve

Përmirësimi i shërbimeve komunale karshi qytetarëve duke u fokusuar qasjen më të lehtë të tyre në administratë

Pesë fushat prioritare të komunës dhe objektivat e saj për periudhën afatmesme 2020-2022 do të shoqërohen me një indeks të hyrash dhe shpenzimesh në të pesë kategoritë ekonomike të cilat do të mund të monitorohen dhe raportohen karshi arritjeve.

Historiku i shkurtër komunës së Vitisë në fushat :

Zhvillimi Ekonomik

Vitia, nëpër të cilën kalon lumi Morava e Binçës, shtrihet në pjesën qendrore të fushë gropës së Moravës së Epërme. Lumi Morava e Binçës, në të cilën derdhet edhe lumi Letnica, ka një rëndësi të madhe ekonomike, meqë mundëson ujitjen e tokave. Ndonëse konsiderohet si njëra ndër komunat më të pazhvilluara të Republikës së Kosovës (me një infrastrukturë të kënaqshme rrugore, por jo edhe me rrjetin e ujësjellësit të kanalizimit). Vitia e vendosur në një rrafshinë shumë pjellore, ka mundësinë e kultivimit të, të gjitha bimëve bujqësore. Kjo është edhe arsyeja që sektori i bujqësisë është njëri ndër sektorët kryesor të zhvillimit ekonomik të komunës së Vitisë, edhe pse viteve të pasluftës ka ngelur prapa në këtë drejtim, për të krijuar një përparësi tregtia dhe më pak zejtaria. Sidoqoftë, Komuna e Vitisë ka potencial të madh të zhvillimit të sektorit bujqësor.

Përparësitë e komunës së Vitisë për zhvillimin e bujqësisë janë:

- Numri i madh i fermerëve dhe tradita në bujqësi
- Kualiteti i mirë i tokës bujqësore
- Rendimentet e mira në perimtarë
- Ekspert të mjaftueshëm të sektorit bujqësor etj...

Duke pasur parasysh zhvillimin e bujqësisë në të ardhmen në komunën e Vitisë është hartuar një strategji për zhvillimin bujqësor që në vete përthëhet:

- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore- rurale
- Projektet për ngritjen e kapaciteteve përpunuese
- Ndërrimi i metodologjisë në kultivimin e kulturave lavërtare (grurit dhe misrit)
- Rritja e kapaciteteve të fermave (kalimi i tyre nga fermat e vogla në ferma të mesme dhe të mëdha)
- Hapja e punkteve grumbulluese për grumbullimin e prodhimeve bujqësore (mënyrë e vetme për bujqit, për ti shitur në mënyrë të sigurt prodhimet e tyre në treg).
- Ngritja e fabrikave për përpunimin e prodhimeve bujqësore
- Zhvillimi më i madh i viseve rurale në bujqësi (ngritja e plantacioneve të pemëve)
- Ngritja e kapaciteteve për zhvillimin e agro-turizmit në komunën e Vitisë.
- Projektet për zhvillimin e bujqësisë organike (nevojë dhe perspektivë e kohës)
- Menaxhimi dhe shfrytëzimi i drejtë i pyjeve, dhe
- Angazhimi i ekspertëve bujqësorë në aktivitetet e bujqësisë etj...

Arsimi

Procesi edukativo arsimor në Komunën e Vitisë përfshinë nivelet e ndryshme si prej atij parafillor e deri te ai i mesëm e i lartë. Mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe dhe në atë serbe dhe ka gjithsej 17 shkolla fillore me 18 paralele të ndara fizike në gjuhën shqipe dhe 3 shkolla të mesme. Gjithashtu në këtë komunë procesin mësimor e zhvillojnë edhe 1 shkollë fillore në gjuhën serbe si arsimit parashkollor-çerdhja "Gëzimi ynë " në Viti.

Në këto institucione shkollore vijonë mësimin rreth 8, 976 (9,324 në vitin 2019 çka do të thotë se kemi 348 nxënës më pak se në vitin 2019 (9324-8976 = 348) shih Qarkoren Buxhetore 2020/01 faqe 14)

Më qellim të ofrimit sa më të mirë të kushteve në fushën e arsimit të kësaj komune për punë dhe për zhvillimin e procesit edukativo mësimor dhe të ngritjes së cilësisë së saj, në agjendën e Institucioneve komunale është jo vetëm përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese shkollore, por edhe ndërtimi i shkollave të reja , komuna planifikon të mbështes :

- Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucionet parashkollore,
- Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin fillor dhe të mesëm,
- Forcimi i mekanizmave të llogaridhënies dhe certifikimit në sistemin .

Shëndetësia

Rjeti shëndetësor në komunën e Vitisë është mjaft mirë i shpërndarë. Qytetarët e Vitisë për të marrë ndihmën dhe kujdesin primar shëndetësor, mund të drejtohen në gjashtë punkte të Mjekësisë Familjare (nëpër disa fshatra të kësaj komune), në katër qendra të mjeksisë familjare ndërkohë që në qytetin e Vitisë ekziston Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare "Nëna Tereze", e cila për qytetarët e Vitisë ofron 24 orë shërbime dhe ambulanta në fshatin Pozheran edhe kjo ambulant ofron 24 orë shërbime për qytetarët e Vitisë. Këto qendra e punkte, i mundësojnë Vitiasve që brenda 10-15 minutave të arrijnë deri në ambulancë ku mundë ti ofrohet kujdesi primar, shëndetësor.

Në QKMF " Nëna Tereze" kryhen këto shërbime:

- Shërbimi i përgjithshëm
- Shërbimi i mjekësisë familjare
- Shërbimi gjinekologjik
- Shërbimi internistik
- Shërbime rentgeni
- Shërbimi pediatrik
- Shërbimi Stomatologjik dhe Shërbimi për vaksinim.

Kjo qendër ka rreth 139 të punësuar, ndërkaq numri 094 është gjithnjë i hapur për thirrjet emergjente.

Kultura

Institucioni përgjegjës për zhvillimin e jetës kulturore në komunë e Vitisë është Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e cila organizohet nga këta sektor:

- Sektori për Kulture,
- Sektori për Rini dhe Sport
- Sektori i Bibliotekës Publike Komunale
- Sektori i Arkivit Historik

Organizimet kulturo-sportive Statutare në kuadër të kësaj drejtorie janë:

- "Flakadani i Karadakut", 21-26 Mars
- "2 Korriku"- 18 Qershor- 2 Korrik
- Dita e çlirimit e Komunës së Vitisë, 14 Qershor
- 5 Maji, Dita e Dëshmorëve të Atdheut

Ndërkaq manifestimi kulturor, letrar e shkencor " Takimet e Dom Mikelit" është një manifestim tradicional me përmasa gjithëkombëtare. Ky manifestim organizohet nga Shoqata e Kulturore Shkencore "Dom Mikel Tarabulluzi" me qendër në fshatin Stubëll. Ky manifestim tradicional organizohet që nga viti 1990 dhe mbahet zakonisht të premten dhe të shtunën e parafundit të muajit shtator, në shenjë të shënimit të Shkollës së parë shqipe në Kosovë, më saktësisht në fshatin Stubëll 1584-1905 dhe në shenjë të përkujtimit të mësuesit të saj Dom Mikel Tarabulluzit, ndër aktivitete tjera të cilat organizohen apo mbështeten nga DKRS tradicionalisht janë: Ditët e Zojës së Bekuar, 17 Shkurti-Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, 3 Maji-Dita Botërore e Lirisë së Shtypit, 9 Maji- Dita e Evropës, 1 Qershori- Dita Ndërkombëtare e Femijëve, 15 Shtatori- Dita Ndërkombëtare e Demokracisë, 26 Nëntori- American Thanksgiving, 28 Nëntori- Dita e Flamurit Kombëtar, 8 Marsi- Dita Ndërkombëtare e Gruas, 7 Marsi- Dita e Mësuesit ndërsa nga kodi buxhetor i DKRS-se gjatë vitit fiskal shpërndahen subvencionet sipas kërkesave.

Në kuadër të bibliotekës komunale të Vitisë ekziston një fond librash prej 54.556 dhe atë në gjuhët: shqipe, serbokroate, angleze, frënge e turke). Në kuadër të kësaj biblioteke funksionon sektori për të rritur dhe të vegjël gjithashtu përveç fondit të librave tekstual kjo bibliotekë ka edhe fondin auditiv (për të verbër) por ky fond është vetëm në gjuhën angleze. Numri i lexuesve është gjithnjë në rritje dhe ky numër është afër 11.000, ndërkohë që këtë vit janë të regjistruar 1.186 lexues. Kjo bibliotekë është e vendosur në Shtëpinë e Kulturës "Bajram e Gursel Sylejmani" në Viti dhe gjithashtu në kuadër saj funksionon biblioteka në: Pozheran, dhe Sllatinë e Epërme.

Gjatë vitit 2018 Biblioteka Publike Komunale ka zhvilluar të gjitha aktivitetet e veta konform Ligjit dhe planit të punës për vitin 2019, duke kryer detyrat e veta dhe duke qenë në shërbim të lexuesve, duke u angazhuar në ngritjen e nivelit të shërbimeve, më qëllim që qytetarëve dhe lexuesve të rregullt t'i u ofroj kushte sa më kualitative dhe shërbim sa më cilësor.

Biblioteka Publike gjatë vitit 2017 është angazhuar rreth përmirësimit të kushteve të Bibliotekave amë dhe në dege.

III. Korniza Fiskale Komunale

3.1 Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtëpërdrejt politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore) mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyrën fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën më poshtë. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit Korniza Afatmesme të Shpenzimeve (KASH-Qarkorja buxhetore) 2020-2022 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Komponentet e politikës makroekonomike sic janë Bruto Produkti Vendor, inflacioni dhe demografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2020-2022 e Qeverisë së Kosovës bazuar në të dhënat historike si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike dhe sociale të vendit .

Ka indikacione se do të ketë ecuri pozitive të rritjes ekonomike në vitet e ardhshme, më saktësisht në periudhën 2020-2022 parashihet një rritje globale vjetore 4.6% (shih KASH 2020-2022 faqe 23).

Natyrisht se rritja ekonomike ndryshe përkthehet edhe në krijimin e vendeve të reja të punës dhe zbutjen e papunësisë në Komunë, që në periudhën afatmesme ullet nga niveli i përgjithshëm i papunësisë .

Komuna nga ana e saj do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të tyre, rrejdhimisht rritjes së të hyrave buxhetore komunale, rritjes reale duke pasur parasysh mbledhjen e të hyrave vetanake .

Aktualisht financimi komunal përfshinë: **1. Të Hyrat Vetanake dhe 2. Grantet Operative.**

Tabela 1: Indikatorët ekonomik

	2019 (aktual)	2020	2021 (vlerësim)	2022 (vlerësim)
Indikatorët makroekonomik në Kosovë				
Rritja reale e BPV në %	4.7	4.7	4.5	4.6
Inflacioni në %	1.7	1.3	1.3	1.3
Indikatorët ekonomik komunal				
Popullsia e Komunës	46,926	47,986	48,426	48,826
Numri i bizneseve të regjistruara	1,479	1,550	1,670	1,710
Numri i nxënësve	9,324	8,976	8,800	8,700

Burimi: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, Qeveria e Kosovës, 2020-2022 (faqe 32).


3.2 Tendanca e të hyrave komunale dhe parashikimi afat-mesëm 2020-2022

Buxheti i Komunës së Vititë përbëhen nga dy burime kryesore.

1. Grantet qeveritare dhe
2. Të hyrat vetanake komunale .

Figura 1: Buxheti i Komunës në vite (2020 – 2022), milion Euro;

Buxheti sipas viteve



Në bazë të planifikimit të bërë nga viti 2019 grantet për Komunën e Vitisë si tërësi do të shënojnë rritje **7.95%**. Buxheti në vitin 2018 ishte në shumë prej – 11,097,985 €, vitin 2019 është në shumë prej - 11,399,551 €, vitin 2020 është- 12,305,492 €, në vitin 2021 – 12,729,920 €, në vitin 2022 -13,194,610 €,) sipas të dhënave të prezantuara në tabelën më poshtë, këto të dhëna kryesisht bazohen në të dhënat e përgjithshme buxhetore që planifikohen në nivel të Qeverisë nacionale, sic parashihet me KASH-in 2020-2022. Rritja për vitin 2020 kryesisht është reflektuar në grantin e përgjithshëm në shumë prej 500,900 € ose në krahasim me vitin 2019 në 11.34 %, grantin specifik të arsimit në shumë prej 440,094 € ose në krahasim me vitin 2019 në 9.97 %, grantin e shëndetësisë në shumë prej 172,094 €, kanë shënuar rënje të hyra vetanake në shumë prej 94,374 € në krahasim me vitin 2019 në 9.05 %, nuk kemi mjete të planifikuara në fondin e huamarrjes siq kishim në vitin 2018 dhe 2019 .

Në vitin 2020 kemi rritje në grantet operative (i përgjithshë, specifik i arsimit dhe spacific i shëndetësisë) në shumë prej 1,113,084 € .

Të hyrat vetanake komunale në krahasim me vitin 2019 në vitin 2020 kanë shënuar zbritje prej 94,374 , në vitin 2019 kanë qen të planifikuara në vlerë prej 1,042,973, në vitin 2020 janë të planifikuara në vlerë prej 948,599 €, për vitin 2021 në krahasim me vitin 2020 janë rritur për 66,238 €, për vitin 2022 ka rritje prej 132,507 € në krahasim me vitin 2020 (kufijt e caktuar nga komisioni i granteve në nivel ndërqeveritar Qarkore buxhetore e komunave 20209/01).

Tabela 2: Planifikimi i të hyrave komunale sipas burimit për vitet 2020-2022, dhe viti aktual 2019 në euro

Komuna: Viti	Grantet , Huamarrjet dhe THV - 2019	Grantet dhe THV – 2020	Grantet dhe THV – 2021	Grantet dhe THV - 2022
	në Euro	në Euro	në Euro	në Euro

Burimet e të Ardhurave					
0	GRANTET	10,243,809	11,356,893	11,715,083	12,113,414
1.	Granti i Përgjithshëm	4,406,302	4,919,202	5,189,845	5,497,975
2.	Granti i Arsimit	4,373,897	4,855,987	4,880,266	4,904,668
3.	Granti i Shëndetësisë	1,409,610	1,581,704	1,644,972	1,710,771
4.	Fondi i huamarrjes	112,769			
	TOTALI I TË HYRAVE KOMUNALE	1,042,973	948,599	1,014,837	1,081,196
	TOTAL BUXHETI PËR VITE	11,399,551	12,305,492	12,729,920	13,194,610
Nr.re n.	Burimet e të Ardhurave				
I-A.	TË ARDHURAT E ADMINISTRATËS KOMUNALE - Direkte				
1	Liçensat komerciale dhe të biznesit / Lejet	2.500	2.500	2.500	4.500
1.1.	Funksionimet e dyqaneve të mëdha dhe shërbimeve tjera				
1.2.	Funksionimet e aktivitetëve industriale ose aktivitetëve të lidhura me ndërtimin				
1.3.	Funksionimi me shitore në rrugë ose afër rrugëve, kiosqe, karroca të vogla lëvizëse (pranimi teknik i lokait)	2.500	2.500	2.500	4.500
1.4.	Funksionimet e bankave, bashk. të sigurimit dhe shërbimeve tjera. finansiare				
1.5.	Funksionimet e Gurëthyesve, minierave	-	-		
2	Liçensat për lojra zbavitëse, pije alkoolike, reklamime, shpallje etj. / Lejet	-	-	-	-
2.1.	Funksionimet me makina me monedha ose me lojra dh të ngjajshme				
2.2.	Funksionimet dhe vendosja e shërbimit të pijeve alkoolike				
2.3.	Reklamimi, publikimi në pronën Komunale				
3	Liçensat profesionale / Lejet	-	-	-	-
3.1.	Funksionimi i shërbimeve profesionale (Avokatët, Mjekët, Dendistët, etj)	-	-		
4	Shfrytëzimi i Tokës dhe Lejet e ndërtimit	62.400	97.441	105.000	105.000
4.1.	Lejet për ndërtim dhe konstruktive	54.000	74.000	80.000	80.000
4.2.	Pagesat e ndërrimit të destinimit të tokës ekzistuese	8.400	23.441	25.000	25.000
4.3.	Pagesat e demolimit				
4.4.	Pagesat me ndikim nga shfrytëz. i madh i rrugëve publike apo i shërb. publ. të siguruar për ndërtim ose operim komerc. duke përfshirë edhe vendet e nxjerrjes së resurseve nat.				
4.5.	Tatimet nga nxjerrja e Resurseve natyrore (Neni 10.5 CFA Udhëzim Ad. Nr.2001/03 dhe 2001/02 DLA)				
5	Inspektimi i tokës dhe aktivitetet Gjeodezike	80.200	80.200	89.500	89.500
5.1.	Fleta poseduese dhe kopje plani	30.900	30.900	34.500	34.500
5.2.	Aktivitetet në teren që kanë të bëjë me matjen e vendit	19.200	18.600	21.000	21.000
5.3.	Taksë regjistrimi i trashëgimis / bartja e pronesis	30.100	30.700	34.000	34.000
6	Shërbimet e inspektimit të Shëndetit dhe Sigurisë	400	3.600	7.200	7.300
6.1.	Inspektimi i objekteve që ofrojnë ushqim dhe akomodim publik				
6.2.	Inspektimi i ambientit	400	3.600	7200	7300
6.3.	Inspektimi i ndërtimit, shërbimit të zjarrefikësve dhe konstruktimit				

7	Shfrytëzimi i pronës Komunale	24.848	27.088	30.058	26.711
7.1	Baza ditore apo bazat tjera për shfrytëzimin e pronës publike për aktivitetet komerciale apo jo komerciale	8.400	8.640	8.760	8.711
7.2	Ngarkesat për hapsirë në tregje ose në objekte të ngjajshme	400	2.400	4.000	4.000
7.3	Marrja me qira e objekteve komunale për një afat të gjatë	13.548	13.548	13.548	14.000
7.4	Te hyrat nga shitja e pronës komunale	2.500	2.500	3.750	
8	Pagesat në lidhje me Automjetet	80.700	91.900	92.100	105.600
8.1	Lejet e automjeteve për autotaksi	1.200	2.400	2.600	2.600
8.2	Parkimi në parkingun publik i paisur me garazhim apo hapsira tjera				
8.3	Gjobat në trafik				
8.4	Largimi dhe deponimi i automjeteve				
8.5	Regjistrimi i automjeteve	79.500	89.500	89.500	103.000
9	Çertifikatat dhe Dokumentet Zyrtare	69.047	68.782	68.990	72.189
9.1	Pagesat e regjistrimit të pronës dhe të transferit				
9.2	Dokum lidhur me statusin shoqëror si dhe të lindjes, vdekjes, martesës, shkëmbimit	36.300	36.000	40.000	40.000
9.3	Pagesat për kopjet shtesë të certifikatave/dokumenteve	1.500	1.500	1.500	2.000
9.4	Taksa administrative				
9.5	Të tjera	31.247	31.282	27.490	30.189
10	Taksa e pronës	400.000	430.000	442.000	492.285
10.1	Pagesat e taksës së pronës	400.000	380.000	382.000	412.285
10.1	Pagesat e taksës së tokës		50.000	60.000	80.000
11	Të ardhurat tjera	31.548	35.078	56.000	56.000
11.0	Përfitimi nga privatizimi				
11.1	Regjistrimi i Biznesit -				
11.2	Te hyrat nga kontestet e komunesAdministrata e Unmikut				
11.3	Gjobat tjera				
11.4	Pagesat tjera	31.548	35.078	56.000	56.000
I-A.	Nëntotali I-A , Të ardhurat direkte (Tarifat dhe ngarkesat)	751.643	836.589	893.348	959.085
I - B.	TË Ardhurat e Administrates komunale - Indirekte	206.810	-	-	-
1.0	Denimet në komunikacion,të grumbulluara përmes Nivelit Qendror (ShPK)	75.000			
1.1	Gjobat e ghykatave	120.810			
1.2	Denimet e ekonomisë së pyjeve	11.000			
- 1.3					
	Nëntotali I-B , Të ardhurat indirekte (Pjesa që i takon komunave)				
I	Totali I Administrates komunale (Direkte dhe Indirekte & IA+IB)	958.453	836.589	893.348	959.085

	TË ARDHURAT NGA ARSIMI				
1	Qerdhet	20.000	20.000	21.000	21.000
2	Arsimi parashkollor				
3	Arsimi fillor				
4	Arsimi i mesëm	2.000	9.000	10.000	10.000
5	Të tjera				
II	Totali - Arsimi	22.000	29.000	31.000	31.000
	Të ARDHURAT NGA SHËNDETËSIA				
1	Shëndetësia primare	60.000	72.000	78.311	78.311
2	Të tjera	2.520	11.010	12.178	12.800
III.	Totali - Shëndetësia	62.520	83.010	90.489	91.111
	TOTALI I TË ARDHURAVE VETANAKE TË KOMUNES (I+II+III):	1.042.973	948.599	1.014.837	1.081.196

Në planifikimin e buxhetit nuk kalkulohen të hyrat e nivelit qendror – të hyrat indirekte por vetëm të hyrat direkte .

Buxheti komunal vazhdon të dominohet nga transferet qeveritare në tri vitet e ardhshme do të përbëjnë afërsisht 92.29 % (11,356,893 €) të buxhetit total të komunës kurse nga të hyrat vetanake të komunës me 7.72 % (948,599 €) .

	Shuma në €	%
Transferet qeveritare/grantet	11.356.893	92,29
Të hyrat vetanake Komunale	948.599	7,71
Totali	12.305.492	100,00

3.2.2 Politikat e reja

Së pari , Komuna e Vitisë në tri vitet e ardhshme do të bëjë përpjekje në mobilizimin e resurseve komunale me qëllim të adaptimit të politikave të reja që ka inicuar qeveria nacionale e Republikës së Kosovës, por edhe të atyre të inicuar në nivelin e qeverisë komunale.

Me këtë Qarkore përcaktohen grantet qeveritare për financimin e komunave për vitin 2020 dhe orientimet për vitet 2021-2022, bazuar në prioritetet strategjike të Qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare. Po ashtu, kjo Qarkore përcakton nivelin e të hyrave vetanake të komunave për vitin fiskal 2020 si dhe parashikimin afatmesëm 2021-2022.

Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2020, bazohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) dhe Tabelën 1 të projeksioneve makro-fiskale, të përgatitur nga Ministria e Financave siç specifikohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Komisioni i Grantëve në takimin e mbajtur me date 23.04.2019 ka aprovuar financimin komunal për vitin 2020 dhe projeksionet për vitin 2021-2022.

Procesi i buxhetit komunal merr parasysh këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël,
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës,
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale, si dhe
- Përcaktimi i strukturës së shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve.

Komunat janë të obliguara të përgatisin Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale për vitin 2020-2022, dhe të aprovon në Kuvendin Komunal deri me datë 30.06.2019 si dokument strategjik komunal, i cili dokument pasqyron caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore si dhe strukturën e shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve.

Ndonëse ende nuk është pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Qeverisë së Kosovës 2020-2022, sygjerimet të Qeverisë së Kosovës janë që shumica e Grantit të Përgjithshëm të komunave që aktualisht është dhjetë përqind e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore, (duke përjashtuar mbështetjen buxhetore dhe grantet, të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga interesi si dhe taksat, ngarkesat tjera të qeveris lokale. Bazuar në tabelën nr të qarkores buxhetore 2020/01 të përgaditur nga Departamenti i politikave ekonomike, publike dhe bashkëpunimit ndërkombëtar financiar të ministrit të financave në përputhje me LFPL, granti i përgjithshëm për komuna për vitin 2020 është aprovuar nga komisioni i granteve në shumë prej 196.3 milion €. Kjo ndarje bazohet në formulën e përcaktuar nga neni 24 të LFPL, sipas këtij neni 10% e të hyrave totale të buxhetuara të qeveris qendrore ju ndahen komunave duke përjashtuar mbështetjen buxhetore dhe grantet, të hyrat nga tatimi në pronë, interesi, taksat, dhe të hyrat vetanake të komunave(shig QB2020/01 faqe 9).

Me qëllim të nivelizimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetanake të komunave më të vogla, bazuar në LFPL, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse prej 140,000 euro, duke zbritur nga 1 euro për kokë banori ose 0 euro për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë. Pas kësaj, shpërndarja e bërë nëpër komuna bazohet në formulën për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna sipas LFPL: (i) numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%); (ii) përmasat gjeografike të komunës me gjashtë përqind (6%); (iii) numri i popullsisë pakicë në komunë me tre përqind (3%); (iv) komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat me dy përqind (2%).

Financimi i shërbimeve sociale si kompetencë e transferuar nga MPMS në komuna duhet të financohet nga granti i përgjithshëm komunal. Të punësuarit në administratën e Drejtorive Komunale për Arsim arsimor dhe Shëndetësi primare financohen nga granti i përgjithshëm në komuna. Po ashtu, nga granti i përgjithshëm do të plotësohen edhe grantet specifike për arsim para universitar dhe shëndetësi primare kur është e nevojshme.

1.2.

Projeksionet e bëra për vitin 2020 dhe vlerësimet për vitin 2021 dhe 2022 në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Kosovës, reflektojnë rritje të grantit qeveritar në bazë të qarkores buxhetore 2020/01 në këto grante si :

1. Granti i përgjithshëm shuma e rritjes nga viti 2019 në vitin 2020 në shumë prej 500.900 €,
2. Granti specifik i arsimit shuma e rritjes për 440,090 €,
3. Granti specifik i shëndetësisë (vetëm për kujdesin primar shëndetësor) shuma e rritjes prej 172,094 €

Totali i rritjes së grantit qeveritar është në shumë prej 1,113,084 €. Kemi zbritje të shumës së të hyrave vetanake prej 94,374 € nga shuma 1,042,973 e vitit 2019 në shumën prej 948,599 € në vitin 2020).

Së dyti, komuna e Vitit ka rritje të granteve qeveritare (1,113,084 €.), arësyeja është rritja e e këtij granti në nivel vendi nga 180,69 milion € në vitin 2019 në 196.28 milion € në vitin 2020 (shih QB 2020/01 faqe 10), implementimi i ndryshimeve ligjore të cilat bartin kosto shtesë të shpenzimeve, implementimi i pjesës së kontratës kolektive që

ndërlidhet me përvojën e punës si dhe adresimin e pakos së reformës së administratës publike, pagesa e tri pagave pas pensionimit të punëtorëve arsimor.

Qarkorja buxhetore përfshinë të gjitha kategoritë e shpenzimeve, me përjashtim të pagave dhe mëditjeve. Kjo është për arsye se siç jeni të informuar kohë më parë në Kuvend janë miratuar pakot e ligjeve të Reformës së Administratës Publike, mirëpo aktet nën-ligjore ende nuk janë miratuar, në këtë drejtim Komisionet përkatëse janë duke punuar në përcaktimin e koeficienteve për të gjitha pozitat dhe me qarkoret pasuese do të njoftoheni lidhur me kufirin në paga.

Së treti, në rast se në periudhën afatmesme Qeveria e Kosovës do të ndryshojë formulën shtetërore të ndarjes së grantit të arsimit për Komuna, ndarje kjo që është bërë në qarkoren buxhetore 2020/01 në bazë të numrit të nxënësve (për komunën tonë prej 8,976 (9,324 në vitin 2019 çka do të thotë se kemi 348 nxënës më pak se në vitin 2019 (9324-8976 = 348), do të thotë se nga viti i kaluar kemi numër në planifikimin e buxhetit më pak për 348 nxënës), atëherë kjo do të ketë ndikim në buxhetin e Komunës, sepse koston e pagesës së përvojës së punës për 0.5% për çdo vit pune ka shënuar ngritje të vlerës së buxhetit. Financimi i programit të administratës së arsimit, administratës së shëndetësisë dhe shërbimeve sociale bëhet nga granti i përgjithshëm.

Grantin specifik për arsim parauniversitar për vitin 2020 është aprovuar në shumë prej 205.5 milion euro, nga të cilat 192.1 milion euro janë paga dhe mëditje, 10.8 milion euro janë mallra dhe shërbime dhe 2.5 milion euro shpenzime kapitale. Granti Specifik për Arsim sipas LFPL, bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e arsimit parauniversitar të MASHT për vitin 2020.

Formula trajton nivelin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm, duke marrë për bazë këto kriteret:

- a) Numri i nxënësve të regjistruar për vitin 2018/2019;
 - b) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit shumicë 1:21.3 (bazuar në Udhëzimin administrativ nr.22/2013 të MASHT);
 - c) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit pakicë 1:14.2;
 - d) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin parashkollor 1:12;
 - e) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin e mesëm profesional për nxënësit shumicë 1:17.2, dhe për nxënësit pakicë 1:11.5;
 - f) Raporti nxënës-mësimdhënës për zonat malore 1:14.2;
 - g) Kalkulimi për stafin mësimdhënës të gjuhës angleze për klasën I dhe II;
 - h) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 630 nxënës 1 staf në arsimin parafillor dhe fillor;
 - i) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 470 nxënës 1 staf në arsimin e mesëm;
 - j) Kalkulimi për stafin mësimdhënës në lehonë është paraparë 3% (bazë stafi mësimdhënës);
 - k) Kalkulimi për stafin ndihmës për 170 nxënës 1 staf (pastrues) si dhe 1 staf për shkollë (roje);
 - l) Shërbimi profesional;
 - m) Koordinatorët e cilësisë; 13;
 - n) Kalkulimi i pagave është bazuar në Ligjin e Pagave;
 - o) Mallrat dhe shërbimet janë kalkuluar sipas kriterit për nxënës (23 euro për nxënës shumicë dhe 25 euro për nxënës pakicë) dhe për shkollë (1,500 euro për shkollë parafillore dhe fillore dhe 3,250 euro për shkollë të mesme);
 - p) Kapitallet janë kalkuluar sipas kriterit 7 euro për nxënës;
 - q) Kalkulimi i tri pagave pas pensionimit me kosto prej 1.4 milion euro;
 - r) Asistent për fëmijë me nevoja të veçanta me kosto prej 0.78 milion euro;
- Sipas MASHT është raportuar numri për 11,938 nxënës më pak në arsim parauniversitar krahasuar me vitin paraprak. Duke u bazuar në zvogëlimin e vazhdueshëm të numrit të nxënësve nga viti në vit dhe duke marrë për bazë parametrat mësimdhënës/nxënës sipas gjendjes aktuale, MASHT kërkon nga komunat se me rastin e pensionimit të stafit mësimdhënës mos të shpallin konkurs për pranimin e kuadrit të ri, por të sistemojnë mësimdhënësit të cilët nuk kanë normë ose nuk kanë normë të

Së katërti, Komuna e Vitisë ndonëse me informata të limituara do të jetë e ndikuar në aspektin buxhetor edhe me rastin e fillimit të aplikimit të Ligjit për gradim në paga që QB 2020/01 përfshinë të gjitha kategoritë e shpenzimeve, me përjashtim të pagave dhe mëditjeve. Kjo është për arsye se siç jeni të informuar kohë më parë në Kuvend janë miratuar pakot e ligjeve të Reformës së Administratës Publike, mirëpo aktet nën-ligjore ende nuk janë miratuar, në

këtë drejtim Komisionet përkatëse janë duke punuar në përcaktimin e koeficienteve për të gjitha pozitat dhe me qarkoret pasuese do të njoftoheni lidhur me kufirin në paga, ndonëse ende nuk është bërë ndonjë analizë në lidhje me ndikimin fiskal apo buxhetin e Komunës. Komuna nuk posedon me informatat e nevojshme të kostos së gradimit të punëtorëve komunal dhe do të kem një ndryshim të kostos së kalkuluar të pagave të tanishme, nivelin e pagave të saktë të përcaktimit të nivelit të pagave me rastin e aplikimit të pagave me gradimin e pagave të dhe presim në qarkoren e dytë apo tretë.

Së pesti, Komuna e Vitisë do të mirëpriste deklaratimet e Qeverisë Nacionale, që në të ardhmen, sa i përket fleksibilitetit të shpenzimeve në të gjitha kategoritë ekonomike përveç pagave e mëditjeve dhe subvencioneve, shpenzimeve kapitale të kenë mundësi këtë ta bëjnë edhe nga Granti i Përgjithshëm.

Ndërsa sa i përket të hyrave të tjera të Komunës, apo të hyrave vetanake (THV), sërisht qeveria nacionale ka shtyrë drejt politikave të reja që do të orientonin komunën drejt avancimit të tatimeve me potencial të mirë dhe zbehjes eventualisht eliminimit të atyre taksa e ngarkesa komunale që rëndojnë ambientin biznesor komunal, janë jo transparente dhe fer, karshi qytetarëve respektivisht tatimpaguesit komunal.

Duke u bazuar në analizën e të hyrave të tatimit në pronë, ngarkesës tatimore dhe të paarkëtueshmëve kemi pasur rezultat pozitiv në vitin 2018 në shumë 329,525.20 € në krahasim me vitin 2017 në shumë e 292,114.90 € diferenca pozitive prej 37,410.03 € kemi rritje të inkasimit por duhet të merren masa të tjera të rritjes së shumës së arkëtimit të këtij tatimi që % e të hyrave të jetë shumë ma e madhe duke u mobilizuar me forma tjera të vetëdijësimit të qytetarëve për shlyerjen e borxheve.

Tabela 3: Shuma e tatimit në pronë e vlerësuar për 2019, me normat aktuale tatimore dhe ato të ngritura.

Komuna	Numri i faturave tatimore	Shuma aktualisht e vlerësuar tatimore	Fatura mesatare aktuale
Viti	10,389	376,779.15 tatimi në prone, 51,495.12 tatimi në tokë = 428,274.27 €	41,22 €

Burimi: Databaza e Tatimit në Pronë për Komunën e Vitisë.

3.3 Tendenca e shpenzimeve komunale dhe parashikimi i tyre afat-mesëm për vitet 2020-2022


Përmes Qarkores Buxhetore komunale 2020/01 komunat do të kenë edhe në të ardhmen fleksibilitet në shpërndarjen e të hyrave vetanake komunale në strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2020, duke përjashtuar kategorinë paga dhe mëditje. Si rezultat Komuna e Vitisë prezanton këtë ndarje të shpenzimeve në mes të kategorive të lejuara buxhetore.

Paraqitja e buxhetit sipas kategorive ekonomike

Tabela 5

657	Kategorit ekonomike	Shuma	%
111	Pagat dhe shtesat	7.875.118	64,00
130	Mallrat dhe Shërbime	1.623.250	13,19
140	Shpenzime Komunale	279.000	2,27
200	Subvencione, transfere	277.000	2,25
300	Shpenzimet Kapitale	2.251.124	18,29
TOTALI		100.00	

Paraqitja e kategorive ekonomike në %



Shuma e kategorive ekonomike të buxhetit për vitin 2020 në %

Figura 2: Shpenzimet komunale të buxhetit në kategori ekonomike për vitin 2020

Pagat dhe Mëditjet

Gjatë vitit 2020 kategoria e pagave e mëditjeve do të ngritet për shkak se Qarkorja buxhetore përfshinë të gjitha kategoritë e shpenzimeve, me përjashtim të pagave dhe mëditjeve. Kjo është për arsye se kohë më parë në Kuvend janë miratuar pakot e ligjeve të Reformës së Administratës Publike, mirëpo aktet nën-ligjore ende nuk janë miratuar. Në këtë drejtim Komisionet përkatëse janë duke punuar në përcaktimin e koeficienteve për të gjitha pozitat dhe me qarkoret pasuese do të njoftoheni lidhur me kufirin në paga, pagesa e pagave jubilarë në programin e arsimit dhe një pagë pas pensionimit të shërbyesve civil.

Në kategorinë e pagave e mëditjeve për vitin 2020 është ngritur në shumë prej 511.557 € (sipas kalkulimit shtesë të pagave prej 7 %).

Pjesëmarrja e kategorisë së pagave dhe mëditjeve në shpenzimet përgjithshme buxhetore komunale, është në 64.00 % në total buxhetit.

Programet	Shuma në €	%
Administrata	1.825.411	23,18

Arsim e shkencë	5.040.659	64,01
Shëndetsi dhe mirëqenje sociale	1.009.048	12,81
Totali	7.875.118	100,00

3.3.2 Mallrat dhe Shërbimet

Kategoria e shpenzimeve për mallëra dhe shërbime është e rritur për 141,547 € në krahasim me vitin e kaluar. Pjesëmarrja e kësaj kategorie të shpenzimeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore, gjatë këtij viti në total buxhetin do të jetë 13,19% , paraqitet në tabelë sipas programeve kështu:

Programet	Shuma në €	%
Administrata	870.250	53,61
Arsim e shkencë	391.000	24,09
Shëndetsi dhe mirëqenje sociale	362.000	22,30
Totali	1.623.250	100,00

3.3.3.Shpenzimet Komunale

Kategoria e shpenzimeve komunale është ngritur në 58,000 €. Pjesëmarrja e kësaj kategorie të shpenzimeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore, është 2,27% nga totali i buxhetit komunal dhe paraqitet kështu :

Programet	Shuma në €	
Administrata	134,000	48,03
Arsim e shkencë	100,000	35,84
Shëndetsi dhe mirëqenje sociale	45,000	16,13
Totali	279,000	100,00

3.3.4 Subvencionet

Kjo kategori e shpenzimeve gjatë periudhës së projektuar, është e rritur krahasuar me vitin 2019 për 67.000 €. Pjesëmarrja e subvencioneve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore gjatë vitit 2020 do të jetë 2,25%.

Programet	Shuma në €	%
	235.000	84.84

Administrata		
Shëndetsi dhe mirëqenje sociale	42.000	15.16
Totali	277.000	100.00

Tabela 6:Përmbajtja e shpërndarjes së subvencioneve në periudhën afatmesme

Nr.	Emertimi	Shuma		Shuma	Shuma
		2019	2020	2021	2022
1	Bursa për student	45,000	50,000	55,000	55,000
2	Përkrahje për OJQ-të, klubeve sportive dhe shoqëritë kulturore – artistike	42,000	42,000	45,000	43,000
3	Për organizime, participime dhe ndërhyrje tjera subvencioneve në bujqësi	33,000	53,000	45,000	44,000
4	Ndërhyrje në raste emergjente	60,000	90,000	95,000	93,000
5	Shërbime sociale dhe ndihma tjera shëndetësore	30,000	42,000	42,000	44,000
	Gjithsejt	210.000	277,000	282.000	279.000

3.3.5 Investimet Kapitale

Kjo kategori e shpenzimeve një pjesë e madhe e tyre planifikohet të financohet nga Granti qeveritar në shumë prej 1,772,525 dhe shuma prej 478,559 € nga të hyrat vetanake komunale . Pjesëmarrja e investimeve kapitale në totalin e shpenzimeve të komunës në vitin 2020 është 18.29 % e totalit të buxhetit komunal .

Programet	Shuma në €	%
Administrata	1.993.257	88,54
Arsim e shkencë	140.000	6,22
Shëndetsi dhe mirëqenje sociale	117.867	5,24
Totali	2.251.124	100,00

Tabela 7: Korniza Buxhetore Komunale, në euro

Përshkrimi	2019 (buxheti aktual)	2020 (plani)	2021 (vlerësimet)	2022 (vlerësimet)
1. TË HYRAT TOTALE KOMUNALE	11,286,782	12,305,492	12,729,920	12,194,610
1.1 Të hyrat vetanake	1,042,973	948,599	1,014,837	1,081,196
1.2 Grantet dhe transferet qeveritare	10,243,809	11,356,893	11,715,083	12,113,414
1.3 Fondi i huamarrjes	112,769			
2. SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE	11,399,551	12,305,492	12,729,920	13,194,610
2.1 Shpenzimet rrjedhëse	9,276,264	10,054,368	10,146,615	10,192,885
Pagat dhe mëditjet	7,363,561	7,875,118	7,912,365	7,968,635
Mallrat e shërbimit dhe komunalit	1,702,703	1,902,250	1,952,250	1,945,250
Subvencionet	210,000	277,000	282,000	279,000
2.2 Shpenzimet Kapitale	2,123,287	2,251,124	2,583,305	3,001,725

Tabelat në vijim janë një pasqyrë e shpërndarjes së shpenzimeve komunale në bazë të programeve apo kategorive funksionale si dhe në bazë të kategorive ekonomike. Planifikimet e buxhetit në vijim janë të vitit 2020, vlerësimet buxhetore e vitit 2021 dhe 2022.

Ndryshimet buxhetore janë të reflektuara në të gjitha kategoritë ekonomike paga e mëditje mallra e shërbime shpenzime komunale , subvencione e transfere dhe shpenzime kapitale.

Shpenzimet buxhetore për vitin 2020 të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe Ky është versioni (tabela 8) i planit të ndarjeve buxhetore për vitin 2019 duke ju përmbajtur kufijëve të Qarkores Buxhetore 2020/01 të MF-së .

Tabela 8.

* Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2020

Nr.	Përshkrimi	Stafi	Pagat dhe mëditjet	shtresa me Gradimin e ri të pagave (paga e vjetër *7 %)	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Total
a	d	e	f		g	h	i	j	k
1	SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE	1162	7.363.561	511.557	1.623.250	279.000	277.000	2.251.124	12.305.492
	Grantet Qeveritare	1162	7363561	511557	1430250	279000	0,00	1772525	11356893
	Të hyrat vetanake	0	0	0	193000	0	277000	478599	948599
1	Zyra e Kryetarit	36	281964	19737	150000	0	140000	0	591702
	Grantet Qeveritare	36	281964	19737	140000				441702
	Të hyrat vetanake		0		10000		140000		150000
2	Zyra e Kuvendit Komunal		92300	6461	16000	0	0	0	114761
	Grantet Qeveritare		92300	6461	12000				110761

	Të hyrat vetanake				4000				4000
3	Administrata	35	187221	13105	105000	0	0	0	305326
	Grantet Qeveritare	35	187221	13105	79000	0		0	279326
	Të hyrat vetanake	0	0		26000	0	0	0	26000
3,1	Administrata	33	175137	12260	91000	0	0	0	278397
	Grantet Qeveritare	33	175137	12260	75000				262397
	Të hyrat vetanake				16000				16000
3,2	Komunikimi	2	12084	846	14000	0	0	0	26930
	Grantet Qeveritare	2	12084	846	4000				16930
	Të hyrat vetanake				10000				10000
4	Inspektimet	12	76979	5389	27441	0	0	0	109809
	Grantet Qeveritare	12	76979	5389	23441				105809
	Të hyrat vetanake				4000				4000
5	Financa,Ekonomi dhe Zhvillim	26	161820	11327	36000	0	0	1993257	2200404
	Grantet Qeveritare	26	161820	11327	22000			1524658	1717805
	Të hyrat vetanake				14000			468599	482599
6	Shërbimet publike, mbrojtja civile, emergjenca	34	213079	14916	440809	134000	0	0	802804
	Grantet Qeveritare	34	213079	14916	345809	134000	0	0	707804
	Të hyrat vetanake		0		95000	0	0	0	95000
6.1	Infrastruktura publike	7	41530	2907	407559	124000	0	0	575996
	Grantet Qeveritare	7	41530	2907	317559	124000			485996
	Të hyrat vetanake				90000				90000
6.2	Zjarrfikësit dhe inspektimet	27	171549	12008	33250	10000	0	0	226807
	Grantet Qeveritare	27	171549	12008	28250	10000			221807
	Të hyrat vetanake				5000				5000
7	ZKK	3	16607	1162	3000	0	0	0	20769
	Grantet Qeveritare	3	16607	1162	1000				18769
	Të hyrat vetanake				2000				2000
8	Bujqësi, pylltari dhe zhvill rur	14	66728	4671	13000	0	53000	0	137399
	Grantet Qeveritare	14	66728	4671	13000				84399
	Të hyrat vetanake						53000		53000
9	Kadastra dhe gjeodezia	9	51554	3609	10000	0	0	0	65163
	Grantet Qeveritare	9	51554	3609	7000				62163
	Të hyrat vetanake				3000				3000
10	Planifikimi urban	5	31515	3561	10000	0	0	0	45076
	Grantet Qeveritare	5	31515	3561	8000				43076
	Të hyrat vetanake				2000				2000
11	Shëndetësia dhe mirëqenia sociale	139	1009048	70633	362000	45000	0	119867	1606548
	Grantet Qeveritare	139	1009048	70633	362000	45000	0	119867	1606548
	Të hyrat vetanake		0		0	0	0	0	0
11.1	Administrata	3	19481	1364	2000	0	0	0	22845
	Grantet Qeveritare	3	19481	1364	2000				22845
	Të hyrat vetanake								0

11.2	<i>Shërbimet e shëndetësise primare</i>	136	989567	69270	360000	45000	0	117867	1581704
	Grantet Qeveritare	136	989567	69270	360000	45000		117867	1581704
	Të hyrat vetanake								0
12	<i>Shërbimet sociale</i>	10	58683	4108	8000	0	42000	0	112791
	Grantet Qeveritare	10	58683	4108	8000				70791
	Të hyrat vetanake						42000		42000
13	<i>Shërbimet kulturore</i>	14	75404	5278	51000	0	42000	0	173682
	Grantet Qeveritare	14	75404	5278	40000				120682
	Të hyrat vetanake				11000		42000		53000
14	<i>Arsimi</i>	825	5040659	347599	391000	100000	0	140000	6019258
	Grantet Qeveritare	825	5040659	347599	369000	100000	0	130000	5987258
	Të hyrat vetanake		0		22000	0	0	10000	32000
14	<i>Administrata</i>	17	77762	5443	110000	100000	0	0	293205
	Grantet Qeveritare	17	77762	5443	110000	100000			293205
	Të hyrat vetanake								0
14	<i>Arsimi parashkollor dhe qerdhet</i>	22	117635	8234	27000	0	0	0	152869
	Grantet Qeveritare	22	117635	8234	7000				132869
	Të hyrat vetanake				20000				20000
14	<i>Arsimi fillor</i>	614	3684399	252661	187000	0	0	105000	4229060
	Grantet Qeveritare	614	3684399	252661	187000			100000	4224060
	Të hyrat vetanake							5000	5000
14	<i>Arsimi i mesëm</i>	172	1160863	81260	67000	0	0	35000	1344123
	Grantet Qeveritare	172	1160863	81260	65000			30000	1337123
	Të hyrat vetanake				2000			5000	7000

Tabela 9

* Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2021

Nr.	Përshkrimi	Stafi	Pagat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Total
a	d	e	f	g	h	i	j	k
1	SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE	1162	7.912.365	1.667.250	285.000	282.000	2.583.305	12.729.920
	Grantet Qeveritare	1162	7912365	1440250	285000	0,00	2077468	11715083
	Të hyrat vetanake	0	0	227000	0	282000	505837	1014837
1	Zyra e Kryetarit	36	304964	150000	0	150000	0	604964
	Grantet Qeveritare	36	304964	140000				444964
	Të hyrat vetanake		0	10000		150000		160000
2	Zyra e Kuvendit Komunal		99500	16000	0	0	0	115500
	Grantet Qeveritare		99500	12000				111500
	Të hyrat vetanake			4000				4000
3	Administrata	35	203743	105000	0	0	0	308743
	Grantet Qeveritare	35	203743	79000	0		0	282743
	Të hyrat vetanake	0	0	26000	0	0	0	26000

3.1	Administrata	33	190137	91000	0	0	0	281137
	Grantet Qeveritare	33	190137	75000				265137
	Të hyrat vetanake			16000				16000
3.2	Komunikimi	2	13606	14000	0	0	0	27606
	Grantet Qeveritare	2	13606	4000				17606
	Të hyrat vetanake			10000				10000
4	Inspektimet	12	77988	24000	0	0	0	101988
	Grantet Qeveritare	12	77988	20000				97988
	Të hyrat vetanake			4000				4000
5	Financa, Ekonomi dhe Zhvillim	26	164219	36000	0	0	2257625	2457844
	Grantet Qeveritare	26	164219	22000			1761788	1948007
	Të hyrat vetanake			14000			495837	509837
6	Shërbimet publike, mbrojtja civile, emergjenca	34	230809	448250	140000	0	0	819059
	Grantet Qeveritare	34	230809	348250	140000	0	0	719059
	Të hyrat vetanake		0	100000	0	0	0	100000
6.1	Infrastruktura publike	7	43536	415000	130000	0	0	588536
	Grantet Qeveritare	7	43536	320000	130000			493536
	Të hyrat vetanake			95000				95000
6.2	Zjarrfikësit dhe inspektimet	27	187273	33250	10000	0	0	230523
	Grantet Qeveritare	27	187273	28250	10000			225523
	Të hyrat vetanake			5000				5000
7	ZKK	3	17595	3000	0	0	0	20595
	Grantet Qeveritare	3	17595	1000				18595
	Të hyrat vetanake			2000				2000
8	Bujqësi, pylltari dhe zhvill rur	14	70728	20000	0	45000	0	135728
	Grantet Qeveritare	14	70728	13000				83728
	Të hyrat vetanake			7000		45000		52000
9	Kadastra dhe gjeodezia	9	54493	10000	0	0	0	64493
	Grantet Qeveritare	9	54493	7000				61493
	Të hyrat vetanake			3000				3000
10	Planifikimi urban	5	35521	12000	0	0	0	47521
	Grantet Qeveritare	5	35521	8000				43521
	Të hyrat vetanake			4000				4000
11	Shëndetësia dhe mirëqenia sociale	139	1054531	387000	45000	0	185680	1672211
	Grantet Qeveritare	139	1054531	382000	45000	0	185680	1667211
	Të hyrat vetanake		0	5000	0	0	0	5000
11.1	Administrata	3	20239	7000	0	0	0	27239
	Grantet Qeveritare	3	20239	2000				22239
	Të hyrat vetanake			5000				5000
11.2	Shërbimet e shëndetësisë primare	136	1034292	380000	45000	0	185680	1644972
	Grantet Qeveritare	136	1034292	380000	45000		185680	1644972
	Të hyrat vetanake							0
12	Shërbimet sociale	10	60427	10000	0	42000	0	112427
	Grantet Qeveritare	10	60427	8000				68427

	Te hyrat vetanake			2000		42000		44000
13	Shërbimet kulturore	14	81038	51000	0	45000	0	177038
	Grantet Qeveritare	14	81038	40000				121038
	Te hyrat vetanake			11000		45000		56000
14	Arsimi	825	5456809	395000	100000	0	140000	6091809
	Grantet Qeveritare	825	5456809	360000	100000	0	130000	6046809
	Te hyrat vetanake		0	35000	0	0	10000	45000
14	Administrata	17	81775	103000	100000	0	0	284775
	Grantet Qeveritare	17	81775	103000	100000			284775
	Te hyrat vetanake							0
14	Arsimi parashkollor dhe qerdhet	22	121635	25000	0	0	0	146635
	Grantet Qeveritare	22	121635	5000				126635
	Te hyrat vetanake			20000				20000
14	Arsimi fillor	614	3990399	202000	0	0	105000	4297399
	Grantet Qeveritare	614	3990399	192000			100000	4282399
	Te hyrat vetanake			10000			5000	15000
14	Arsimi i mesëm	172	1263000	65000	0	0	35000	1363000
	Grantet Qeveritare	172	1263000	60000			30000	1353000
	Te hyrat vetanake			5000			5000	10000

Tabela 10

* Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2022

Nr.	Përshkrimi	Stafi	Pagat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Total
a	d	e	f	g	h	i	j	k
1	SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE	1162	7.968.635	1.667.250	278.000	279.000	3.001.725	13.194.610
	Grantet Qeveritare	1162	7968635	1440250	278000	0,00	2426529	12113414
	Te hyrat vetanake	0	0	227000	0	279000	575196	1081196
1	Zyra e Kryetarit	36	306964	150000	0	148000	0	604964
	Grantet Qeveritare	36	306964	140000				446964
	Te hyrat vetanake		0	10000		148000		158000
2	Zyra e Kuvendit Komunal		99500	16000	0	0	0	115500
	Grantet Qeveritare		99500	12000				111500
	Te hyrat vetanake			4000				4000
3	Administrata	35	206043	105000	0	0	0	311043
	Grantet Qeveritare	35	206043	79000	0		0	285043
	Te hyrat vetanake	0	0	26000	0	0	0	26000
3,1	Administrata	33	192137	91000	0	0	0	283137
	Grantet Qeveritare	33	192137	75000				267137
	Te hyrat vetanake			16000				16000
3,2	Komunikimi	2	13906	14000	0	0	0	27906
	Grantet Qeveritare	2	13906	4000				17906

	Të hyrat vetanake			10000			10000
4	Inspektimet	12	78188	24000	0	0	102188
	Grantet Qeveritare	12	78188	20000			98188
	Të hyrat vetanake			4000			4000
5	Financa,Ekonomi dhe Zhvillim	26	165219	36000	0	0	2635246
	Grantet Qeveritare	26	165219	22000		2070050	2257269
	Të hyrat vetanake			14000		565196	579196
6	Shërbimet publike, mbrojtja civile, emergjenca	34	232309	448250	138000	0	818559
	Grantet Qeveritare	34	232309	348250	138000	0	718559
	Të hyrat vetanake		0	100000	0	0	100000
6.1	Infrastruktura publike	7	44036	415000	128000	0	587036
	Grantet Qeveritare	7	44036	320000	128000		492036
	Të hyrat vetanake			95000			95000
6.2	Zjarrfikësit dhe inspektimet	27	188273	33250	10000	0	231523
	Grantet Qeveritare	27	188273	28250	10000		226523
	Të hyrat vetanake			5000			5000
7	ZKK	3	17995	3000	0	0	20995
	Grantet Qeveritare	3	17995	1000			18995
	Të hyrat vetanake			2000			2000
8	Bujqësi, pylltari dhe zhvill rur	14	71728	20000	0	44000	135728
	Grantet Qeveritare	14	71728	13000			84728
	Të hyrat vetanake			7000		44000	51000
9	Kadastra dhe gjeodezia	9	55563	10000	0	0	65563
	Grantet Qeveritare	9	55563	7000			62563
	Të hyrat vetanake			3000			3000
10	Planifikimi urban	5	35821	12000	0	0	47821
	Grantet Qeveritare	5	35821	8000			43821
	Të hyrat vetanake			4000			4000
11	Shëndetësia dhe mirëqenia sociale	139	1084731	387000	40000	0	226479
	Grantet Qeveritare	139	1084731	382000	40000	0	226479
	Të hyrat vetanake		0	5000	0	0	5000
11.1	Administrata	3	20439	7000	0	0	27439
	Grantet Qeveritare	3	20439	2000			22439
	Të hyrat vetanake			5000			5000
11.2	Shërbimet e shëndetësisë primare	136	1064292	380000	40000	0	226479
	Grantet Qeveritare	136	1064292	380000	40000		226479
	Të hyrat vetanake						0
12	Shërbimet sociale	10	61427	10000	0	44000	115427
	Grantet Qeveritare	10	61427	8000			69427
	Të hyrat vetanake			2000		44000	46000
13	Shërbimet kulturore	14	82038	51000	0	43000	176038
	Grantet Qeveritare	14	82038	40000			122038
	Të hyrat vetanake			11000		43000	54000

14	Arsimi	825	5471109	395000	100000	0	140000	6106109
	Grantet Qeveritare	825	5471109	360000	100000	0	130000	6061109
	Të hyrat vetanake		0	35000	0	0	10000	45000
14	Administrata	17	82075	103000	100000	0	0	285075
	Grantet Qeveritare	17	82075	103000	100000			285075
	Të hyrat vetanake							0
14	Arsimi parashkollor dhe qerdhet	22	122635	25000	0	0	0	147635
	Grantet Qeveritare	22	122635	5000				127635
	Të hyrat vetanake			20000				20000
14	Arsimi fillor	614	3999399	202000	0	0	105000	4306399
	Grantet Qeveritare	614	3999399	192000			100000	4291399
	Të hyrat vetanake			10000			5000	15000
14	Arsimi I mesëm	172	1267000	65000	0	0	35000	1367000
	Grantet Qeveritare	172	1267000	60000			30000	1357000
	Të hyrat vetanake			5000			5000	10000

Kategoria Ekonomike – Investimet Kapitale - e prezantuar në detaje më poshtë paraqet një komponentë të rëndësishme të buxhetit të komunës e cila ndonëse nuk përfaqëson pjesën më të madhe të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, mbetet me rëndësi të posaqme në aspektin e planifikimit, për Komunën e Vitisë. Kjo kategori e shpenzimeve në kuadër të shpenzimeve të rregullta buxhetore, ka potencialin më të madh për të nxitur rritjen ekonomike. Andaj, kjo kategori e shpenzimeve, edhe gjatë periudhës së ardhshme afatmesme, do të vazhdojë të jetë në funksion të krijimit të ambientit më të favorshëm për ngritje të pjesëmarrjes së sektorit privat, dhe qytetarëve përmes përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës.

Përderisa ndikimi i këtyre investimeve në punësim dhe konsum është relativisht i shpejtë, ndikim i plotë i tyre në ekonomi do të mund të realizohet vetëm në periudhën afatmesme. Në këtë kontekst përmirësimi i infrastrukturës do të pozicionojë ekonominë e Komunës së Vitisë në një rrugë të rritjes më të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike në një periudhë afatgjatë.

Projektet kapitale të komunës 2020-2022 dhe kostoja në Euro (duhet të përgatitet pas dëgjimeve publike buxhetore).

Më datë 19.06.2019


Viti

Kryetari i Komunës :
Sokol Haliti





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Vitina

PROPOZIM RREGULLORE

PËR

THEMELIMIN DHE STRUKTURIMIN E ASAMBLESË KOMUNALE TË FËMIJËVE

Viti, Qershor 2019

Në bazë të nenit 58, paragrafi 1, pika h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nenit 50, paragrafi 1, pika 1 të Statutit të Komunës së Vitisë Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, kryetari i Komunës paraqet këtë:

PROPOZIM RREGULLORE PËR

THEMELIMIN DHE STRUKTURIMIN E ASAMBLESË KOMUNALE TË FËMIJËVE

DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Qëllimi i Rregullores

Përmes kësaj rregullore, parashihet që nga të gjitha shkollat e mesme të ulëta, në tekstin e mëtejme SHMU, të dërgohen përfaqësuesit e zgjedhur për Asamblenë Komunale të Fëmijëve.

1.1 Plani vjetor i punës hartohet nga Asambleja Komunale e Fëmijëve, në tekstin e mëtejme Asambleja.

Neni 2

Qëllimet e Asamblesë Komunale të Fëmijëve

2.1 Pjesëmarrja aktive në zhvillimin dhe realizimin e veprimeve në fushën e arsimit, shkencës, kulturës, sportit, punës humane dhe aktiviteteve të tjera me interes për fëmijët dhe komunitetin.

2.2 Zhvillimi i bashkëpunimit me këshillat drejtues të shkollave, këshillat e prindërve, këshillat e nxënësve dhe komunitetin lokal.

2.3 Krijimi dhe zhvillimi i bashkëpunimit me mekanizmat dhe organizatat tjera.

2.4 Ngritja e vetëdijes për të drejtat e fëmijës, përgjegjësitë dhe gjithë përfshirja e interesave të fëmijëve/nxënësve.

2.5 Avokim mbi çështje të ngritura nga vet fëmijët.

2.6 Organizimi dhe pjesëmarrja në aktivitete të identifikuara nga vet fëmijët dhe ato që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve.

2.7 Inkurajimi i tolerancës, solidaritetit dhe demokratizimi.

2.8 Promovimi i vlerave shoqërore.

Neni 3

Kompetencat

Obligimet dhe detyrat e Asamblesë:

3.1 Dhënien e kërkesave, mendimeve dhe sugjerimeve për institucionet relevante komunale, për këshillat e shkollës, këshillat e prindërve si dhe drejtoritë, lidhur me zbatimin e rregulloreve të sjelljes në shkollë, planin e zhvillimit të shkollës, aktivitetet e lira, pjesëmarrjen në sporte e

konkurse të tjera dhe organizimin e të gjitha manifestimeve të nxënësve në shkollë dhe jashtë saj në interes të fëmijëve.

3.2 Të siguroj bashkëpunimin e nxënësve, edukatorëve dhe bashkëpunëtorëve profesional.

3.3 Informimin e nxënësve rreth çështjeve me rëndësi të veçantë për arsimimin e tyre përmes komunikimit të rregullt me këshillat e shkollave.

Neni 4

Organizimi i Asamblesë

4.1 Sektori për të Drejtat e Njeriut e ndihmon, monitoron dhe raporton për punën e Asamblesë.

4.2 Asambleja Komunale e Fëmijëve, do të përbëhet nga 27 anëtarë, i njëjtë me numrin e anëtarëve të Kuvendit Komunal.

4.3 Organet e Asamblesë janë: kryetari/ja, kryesia e përbërë nga 5 anëtarë dhe komisione të propozuara dhe të përzgjedhura nga vet asamblistët.

4.4 Njësia për të Drejtat e Njeriut në nivel komunal, organizon zgjedhjet për Asamblenë e Fëmijëve në koordinim me Drejtorinë Komunale të Arsimit.

4.5 Përfaqësimi i nxënësve në Asamble bëhet nga një përfaqësues në çdo shkollë, proporcionalisht me numrin e nxënësve në secilën shkollë.

4.6 Përfaqësuesit e deleguar në Asamble, zgjedhën në SHMU përmes procesit zgjedhor dhe përfshinë nxënësit e klasave gjashtë – tetë (6 - 8).

4.8 Përbërja e anëtarëve të Asamblesë Komunale të Fëmijëve, duhet të ketë reflektim gjinor.

Neni 5

Vendimet e Asamblesë

Asambleja merr vendime për arritjen e qëllimeve të përcaktuara dhe miraton:

5.1 Planin vjetor të punës së Asamblesë.

5.2 Zgjedh dhe shkarkon kryetarin e Asamblesë.

5.3 Shqyrton dhe miraton së paku një raport të kryesisë dhe komisioneve.

5.4 Shqyrton dhe miraton propozimet e anëtarëve të Asamblesë dhe komisioneve.

Neni 6

Mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve për Asamble

6.1 Në takim të përbashkët, këshilli i nxënësve fton kryesinë e klasave nga 6 – 8.

6.2 Nga të gjithë nxënësit e ftuar në takim, përzgjedhjen përfaqësuesit për asamblenë në mënyrë të fshehtë, sipas Nenit 4.5, të kësaj Rregulloreje.

6.3 Secili nxënës prezent në takim ka të drejtë të propozojë dhe të jetë i propozuar.

6.4 Secili nxënës ka të drejtë të deklarohet se a pajtohet të jetë kandidat përfaqësues i shkollës për Asamble.

6.5 Nxënësit e kandiduar për përfaqësues të Asamblesë, paraqiten me një fjalë rasti.

6.6 Përzgjedhja e kandidatëve bëhet përmes procesit të votimit të hapur ose të mbyllur.

6.7 Përzgjedhja e asamblistëve bëhet çdo dy vite.

6.8 Duke respektuar kuotën gjinore dhe gjithëpërfshirjen, përzgjidhen kandidatët të cilët kanë numrin më të madh të votave.

- 6.9 Nëse ka numër të barabartë të votave, atëherë shkohet në raundin tjetër.
6.10 Komisioni zgjedhor është gjithëpërfshirës.

Neni 7

Mbledhjet e Asamblesë

- 7.1 Katër mbledhje të Asamblesë janë obligative gjatë një viti kalendarik, ndërsa është e nevojshme edhe më shpesh me propozim të kryetarit, kryesisë si dhe me iniciativën e një të tretës së anëtarëve.
7.2 Asambleja vendos me shumicën e votave të anëtarëve prezent.
7.3 Anëtarët informohen përmes postës elektronike dhe formave tjera për pikat e rendit të ditës, kushtet e seancës si dhe informata shtesë.
7.4 Kuorumi për mbajtjen e mbledhjeve është gjysma plus një (shumica e thjeshtë).

Neni 8

Përgjegjësitë e anëtarëve të Asamblesë

- 8.1 Anëtarët e Asamblesë kanë mandate dy vjeçar dhe mund të rizgjidhen në të njëjtin funksion.
8.2 Mandati i anëtarëve të Asamblesë përfundon me dorëheqje, pas përfundimit të mandatit ose mungesës pa arsye në tri seancave radhazi.
8.3 Asambleja raporton me shkrim tek udhwheqws i sektorit për të Drejtat e Njeriut në Komunën e Vitisë.
8.4 Secili anëtarë i Asamblesë njofton këshillin e nxënësve në shkollën e vet për punën e Asamblesë.

Neni 9

Të drejtat e anëtarëve të Asamblesë

Një anëtarë i Asamblesë ka të drejtë:

- 9.1 Të marrë pjesë në arritjen e objektivave të Asamblesë.
9.2 Të marrë pjesë në punën e Asamblesë në kushte të barabarta me anëtarët e tjerë.
9.3 Të propozon projektet, veprimet dhe dokumentet e tjera të Asamblesë për vendimmarrje.
9.4 Të marr pjesë në realizimin e të gjitha aktiviteteve të Asamblesë.
9.5 Të informohet në kohën e duhur për punën dhe aktivitetet e Asamblesë.
9.6 Të shprehet lirshëm.
9.7 Të kërkojë dhe të marrë informata nga Kryesia për çështje të rëndësishme në lidhje me ushtrimin e funksionit të asamblistit të ri.
9.8 Të ketë vetëm një propozim për një çështje të caktuar.
9.9 Të shfrytëzojë ambientet e Asamblesë që u janë dhënë në dispozicion për punë dhe takime në bashkëpunim me Komunën dhe Kuvendin Komunal.

Neni 10

Detyrat e anëtarëve të Asamblesë

Anëtarët e Asamblesë janë të detyruar të:

- 10.1 Të kontribuojnë në mënyrë aktive në arritjen e objektivave.
- 10.2 Marrin pjesë në përputhje me interesat e zgjedhësve në aktivitetet e Asamblesë.
- 10.3 Ta respektojnë mendimin e njëri tjetrit.
- 10.4 Kryejnë detyra tjera që I janë besuar atij/asaj nga Asambleja.
- 10.5 T'i përgjigjet ftesës së kryetarit/es së Asamblesë lidhur me Asamblenë.
- 10.6 Të nënshkruhen në fillim dhe mbarim të seancës për praninë e tyre.
- 10.7 Me shumicë votash të aprovojnë, ndryshojnë apo plotësojnë rendin e ditës të propozuar nga kryetari i Asamblesë.
- 10.8 Të votojnë me shumicë votash propozimin e arsyetuar për shtyrjen apo tërheqjen e pikave të caktuara në rendin e ditës.

Neni 11

Mënyra e votimit

- 11.1 Votimet mund të bëhen me vota të hapura ose të mbyllura. Këtë e vendosin asamblistët.
 - a) Votimi i hapur bëhet me ngritjen e dorës, ndërsa
 - b) Votimi i mbyllët (i fshehtë) bëhet me fletëvotime. Votimin e fshehtë e udhëheqë dhe monitoron komisioni i votimit.
- 11.2 Para se të fillohet me votim të fshehtë, Asambleja propozon dhe zgjedhë tre (3) anëtarë të komisionit për numërimin e votave dhe për gjetjen e parregullsive në votime.
- 11.3 Konsiderohet i pavlefshëm fletëvotimi prej të cilit nuk mund të konstatohet me saktësi se si ka votuar asamblisti.
- 11.4 Pjesëmarrësit në votim, kanë vetëm një (1) herë të drejtë të votojnë.
- 11.5 Seancat janë të hapura dhe publike.

Neni 12

Zgjedhja e Kryetarit/es dhe Kryesisë së Asamblesë

- 12.1 Asambleja zgjedh një (1) kryetar, dy (2) nënkryetar, një (1) sekretar, një (1) arkatar.
- 12.2 Të dy nënkryetarët propozohen dhe zgjedhën nga anëtarë e asamblesë duke votuar.
- 12.3 Sekretari dhe arkatari propozohen nga anëtarët e asamblesë dhe votohen nga Asambleja.
- 12.4 Zgjedhja e kryetarit/es bëhet me vota të hapura ose të mbyllura (shih Nenin 11).
- 12.5 Kryetari/ja i/e sapo zgjedhur, pas fjalimit të tij/saj rreth objektivave përgjatë punës menjëherë hapë votimin për përzgjedhjen e Kryesisë (nënkryetarëve, sekretarit/es, arkatarit/es).

Neni 13

Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e kryetarit/es së Asamblesë

- 13.1 Kryetari/ja ka mandate të plotë 2 vjeçar nga moment i zgjedhjes së tij/saj.
- 13.2 Kryetari/ja mund të bëjë propozime dhe ka të drejtë vote, dhe në rast të votimit të barabartë, vota e kryetarit/es është një votë më shumë.
- 13.3 Kryetari/ja ka të drejtë të ndërpresë seancën nëse ka parregullsi.
- 13.4 Ka të drejtë ta largojë asamblistin/en nga salla nëse ka shkelur Kodin e Mirësjelljes.
- 13.5 Kryetari/ja duhet ta thërret mbledhjen së paku katër (4) herë në vit apo sipas nevojës.

13.6 Kryetari/ja nuk duhet të mungojë në tri (3) mbledhje radhazi, po që se ai/ajo mungon pa arsye, atëherë mund të kërkohet shkarkimi i tij/saj.

13.7 Kryetari/ja nuk guxon të bëjë anime (ndarje).

13.8 Nëse kryetari/ja mungon, vazhdon seanca me nënkryetarin/en e parë.

13.9 Nëse mungon edhe nënkryetari/ja i/e parë, atëherë vazhdon me të dytin.

13.10 Nëse kryetari/ja bën shkelje të Rregullores dhe Kodit të Mirësjelljes, ai/ajo mund të shkarkohet me votimin e 2/3 të asamblistëve.

Neni 14

Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e nënkryetarëve

14.1 Asambleja duhet të ketë dy nënkryetarë.

14.1 Nënkryetari/ja i/e dytë duhet të përzgjidhet nga komunitetet joshumicë (nëse ekzistojnë).

14.3 Nënkryetari/ja i/e Asamblesë i ndihmon kryetarin/es në kryerjen e punëve dhe kryen punë të tjera nga fushëveprimet e tij/saj.

14.4 Me autorizimin e kryetarin/es, mund ta zëvendësoj atëbrenda dhe jashtë vendit, varësisht nga agjenda e takimit.

Neni 15

Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e sekretarit/es

15.1 Sekretari/ja i/e Asamblesë bën pjesë në kryesi dhe ka detyrat e përshkruara.

15.2 Sekretari/ja, me kërkesë të kryetarin thirr seancën, cakton datën, orën dhe vendin e mbajtjes së seancës dhe mban procesverbalin.

15.3 Ruan dokumentet e Asamblesë dhe e bën evidentimin e prezencës së asamblistëve.

15.4 Sekretari/ja ka përgjegjësi të monitorojë implementimin e planit të veprimit të Asamblesë.

Neni 16

Detyrat dhe të drejtat e Kryesisë së Asamblesë

16.1 Kryesia e Asamblesë zgjidhet nga vet asamblistët dhe duhet të jetë e përbërë nga pesë (5) anëtarë.

16.2 Anëtari/ja i/e kryesisë nuk mund të ketë më shumë se një post.

16.3 Mbajnë shënime dhe shfaqin idetë e tyre për të mirën e fëmijëve.

16.4 Cakton rendin e ditës në bashkëpunim me anëtarët e kryesisë, (nënkryetarët, sekretari/ja, arkëtari/ja në krye me kryetarin/en).

16.5 Harton planprogramin dhe kalendarin e punës.

16.6 Vendimet e kryesisë miratohen nga Asambleja.

Neni 17

Komisionet

17.1 Komisionet janë organe të përkohshme ose të përhershme, që kujdesen për zbatimin e objektivave të Asamblesë.

17.2 Komisionet që janë organe pune të përhershme:

a) Komisioni për bashkëpunim me organet profesionale të shkollës, këshillin e shkollës, këshillin e prindërve, mësuesit dhe komunitetin lokal.

b) Komisioni për sport dhe kulturë.

c) Komisioni për veprim humanitar.

d) Komisioni për informim.

e) Sipas specifikacioneve të Komunës.

17.3 Vendimi mbi themelimin, përgjegjësitë, shuarjen e komisioneve miratohet nga Asambleja në interesin më të mirë të fëmijëve.

17.4 Çdo komision ka udhëheqësinë e vet, i/e cili/a zgjedhet me votim brenda komisionit (shih Rregulloren).

Neni 18

Komisionet dhe detyrat e tyre

18.1 Komisionet kryejnë të gjitha punët dhe detyrat sipas planit të veprimit.

18.2 Plani i Veprimit i çdo komisioni duhet të aprovohet nga Asambleja.

18.3 Komisionet mbajnë mbledhjen e përgjithshme me kryesinë.

18.4 Shkarkimi i komisioneve bëhet nëse nuk respektojnë dhe nuk mbajnë përgjegjësi për punën e tyre.

Neni 19

Procesverbali

19.1 Për punën e seancës së Asamblesë Komunale të Fëmijëve mbahet procesverbali (shih nenin 15).

19.2 Procesverbali i përmban të dhënat kryesore për punimet e seancës, propozimet e paraqitura dhe konkluzionet e miratuara në lidhje me çështjet e rendit të ditës.

19.3 Procesverbali sipas rregullit i shpërndahet nëpërmes postës elektronike dhe mënyrave të tjera të gjithëasamblastëve më së voni një (1) ditë para seancës që do të mbahet.

19.4 Sekretari/ja i/e Asamblesë, ka për detyrë përgatitjen dhe ruajtjen e procesverbaleve origjinale të seancave të Asamblesë.

Neni 20

Publikimi dhe njoftimi

20.1 Puna e Asamblesës është publike, ku të gjitha procesverbalet, planet e veprimit, minutat e takimeve, publikimet dhe çfarëdo e dalur nga asambltetë, publikohen në web faqen e Asamblesë (<http://akf-rks.org>) dhe mbikëqyret nga Sektori për të Drejtat e Njeriut.

20.2 Kryesia kujdeset për informimin e rregullt të anëtarëve dhe publikut për punën dhe aktivitetet e Asamblesë, qoftë drejtpërdrejtë, komisionit për informim ose përmes publikimit të aktiviteve.

Neni 21

Bashkëpunimi

21.1 Për të arritur qëllimet, Asambleja krijon kontakte dhe bashkëpunon me shoqatat dhe organizatat e tjera profesionale, shkencore, arsimore dhe të ngjashme.

21.2 Asambleja bashkëpunon me Komunën dhe Kuvendin e Komunës.

Neni 22

Mjetet dhe financimi

22.1 Mjetet e nevojshme për funksionimin dhe financimin e aktiviteteve realizohen përmes planifikimit buxhetor komunal dhe qeveritar (buxheti miqësor për fëmijët), mbledhjes së fondeve në shkolla, kontributet vullnetare të nxënësve, mësuesve, prindërve dhe donacionet nga organizatat e biznesit si dhe donator tjerë.

Neni 23

Modifikimi i Rregullores

23.1 Ndryshimet në Rregullore janë të mundshme në bazë të një të tretës (1/3) së anëtarëve të Asamblesë.

Neni 24

Pushimi i punës së Asamblesë

24.1 Asambleja pushon së punuari me vendimin e shumicës së anëtarëve, kur pushojnë kushtet për arritjen e objektivave

Neni 25

Dispozitat përfundimtare

25.1 Për zbatimin e kësaj Rregullore do të kujdeset Sektori për të Drejtat e Njeriut, Drejtoria Komunale e Arsimit si dhe Drejtoritë tjera Komunale.

Neni 26

Hyrja në fuqi

26.1 Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal.

Viti, Qershor 2019

Kryetari i Komunës
Sokol HALITI





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

12-06-2019			
Pranuar - Received	Shërbimi - Service	Vlera - Value	Vendimi - Decision
02-035/02-637			



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Vitina

PROPOZIM RREGULLORE

PËR

REALIZIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE PËRMES SISTEMIT QEVERISËS
KOMUNAL MIQËSOR PËR FËMIJËT

Viti, Qershor 2019

Në bazë të nenit 58, paragrafi 1, pika h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nenit 50, paragrafi 1, pika 1 të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, kryetari i Komunës paraqet këtë:

PROPOZIM RREGULLORE

PËR

REALIZMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE PËRMES SISTEMIT QEVERISËS KOMUNAL MIQËSOR PËR FËMIJËT

(PËR NJË KOMUNË MIKE PËR FËMIJËT)

DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Neni 1

Qëllimet dhe fushëveprimi

- 1.Kjo Rregullore përcakton masat për realizimin e të drejtave të fëmijëve (vajzave dhe djemve) në sistemin qeverisës komunal dhe kontribuon në krijimin e një komune mike për fëmijët.
2. Dispozitat e kësaj Rregullore zbatohen për të gjithë fëmijët më të përjashtuar dhe më të cenuar (pavarësisht racës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimit politik apo ndonjë mendimi tjetër, përkatësisë etnike, pasurisë, aftësisë së kufizuar, prejardhjes familjare të fëmijëve, prindërve të tyre apo kujdestarëve ligjor) dhe shtrihet në të gjitha institucionet të cilat janë nën administrimin e Komunës së Vitisë, apo veprojnë në nivel komunal, përderisa pavarësia e tyre nuk cenohet në përputhje me ligjin.
3. Kjo Rregullore është kontribut për të siguruar se Komuna e Vitisë hap pas hapi po ndërton një shoqëri të barabartë dhe gjithëpërfshirëse.

Neni 2

Përkufizimi i fëmijës

- 1.Fëmijë konsiderohet secili person nën moshën 18 vjeçare.
- 2.Fëmijët deri në moshën 18 vjeçare i gëzojnë të gjitha të drejtat e njeriut siç parashihet në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe në Konventat dhe Standardet tjera të zbatueshme që sigurojnë realizimin progresiv të të drejtave të tyre.
- 3.Fëmijët janë kategori e veçantë e personave të cilët për shkak të moshës, zhvillimit fizik, intelektual dhe pjekurisë duhet t'i realizojnë të drejtat e tyre me mbështetjen e të rriturve. Prindërit, familjet, kujdestarët dhe institucionet e qeverisjes lokale mbajnë përgjegjësi për realizimin e të drejtave të fëmijëve për të siguruar ruajtje dhe kujdes të veçantë, përfshirë mbrojtjen e duhur ligjore para dhe pas lindjes së tyre.

Neni 3

Parimet e përgjithshme për të drejtat e fëmijëve

1. Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës (në tekstin e mëtejshëm Konventa) i obligon shtetet që t'i sigurojnë të drejtat e fëmijës në mënyrë të plotë, siç janë përcaktuar në konventë.

2. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, legjislacioni dhe aktet nënligjore, udhëhiqen nga parimet e Konventës.

2.1. **Mosdiskriminimi**, nënkupton, se të gjithë fëmijët brenda legjislacionit në fuqi i gëzojnë të drejtat e barabarta, pavarësisht racës, ngjyrës, gjinisë, fesë, përkatësisë etnike, sociale, statusit ekonomik të fëmijës, prindërve apo kujdestarit ligjor;

2.2 **Interesat më të mira të fëmijës**, nënkupton, se në rast të ndonjë vendimi nga ana e institucioneve, së pari do të merret parasysh interesi më i mirë i fëmijës, i cili është subjekt i vendimit;

2.3 **E drejta e jetesës, mbijetesës dhe zhvillimit**, nënkupton sigurimin e një jete sa më cilësore për fëmijët, jo vetëm në aspektin fizik, por edhe në atë mendor, emocional, social dhe kulturor;

2.4 **Pikëpamjet e fëmijës**, nënkupton lirinë e fëmijëve për t'i shprehur pikëpamjet e tyre mbi çështjet që lidhen me ta, si dhe obligimin e institucioneve për t'i marrë parasysh ato kur të marrin vendime që ndikojnë tek këta fëmijë, gjithmonë në përputhje me nivelin e zhvillimit të fëmijës.

Neni 4

Komuna mike për fëmijët

1. Komuna mike për fëmijët është një sistem i qeverisjes së mirë lokale, e angazhuar për zbatimin e plotë të Konventës dhe transformimin e Konventës në praktikë të përditshme.

2. Komuna mike për fëmijët i garanton secilit fëmijë që do të:

2.1 Ndikojë apo marrë pjesë në vendimet e Komunës;

2.2 Shprehë pikëpamjet për Komunën;

2.3 Marrë pjesë në jetën familjare të komunitetit dhe në jetën sociale;

2.4 Marrë shërbimet kryesore si kujdesi shëndetësor, arsimimi dhe kujdesi alternative;

2.5 Të jetë i mbrojtur nga shfrytëzimi, dhuna dhe abuzimi apo çfarëdo rreziku tjetër cenues për shkak të moshës apo gjinisë;

2.6 Ecë i sigurt në rrugët e qytetit;

2.7 Takohet dhe luaj me shokët;

2.8 Të ketë hapësira të gjelbëruara;

2.9 Të jetojë në një mjedis të pastër;

2.10 Të marrë pjesë në ngjarjet kulturore, sportive dhe rekreative;

2.11 Të jetë një qytetarë i barabartë i komunës, me qasje në secilin shërbim pa diskriminim.

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 5

Përgjegjësitë për të drejtat e fëmijës

1. Realizimi i të drejtave të fëmijës është përgjegjësi kryesore e familjes dhe institucioneve qendrore e lokale.
2. Institucionet komunale dhe zyrtarët që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve si dhe çdo subjekt tjetër që lidhet me fëmijët, kanë përgjegjësi sociale dhe ligjore për t'u angazhuar në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijës në përputhje me konceptin e komunës mike për fëmijë.
3. Institucionet përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijës në komunë, përfshinë (por nuk kufizohet), këto palë:
 - 3.1 Kryetari I Komunës, Kuvendi Komunal dhe drejtoritë komunale;
 - 3.2 Ministritë e linjës me kompetenca të deleguara;
 - 3.2 Institucionet e drejtësisë (Policia, Prokuroria, Gjykata, Shërbimi Sprovues I Kosovës, Shërbimi Korrektues I Kosovës, etj);
 - 3.3 Sektori për të Drejtat e Njeriut në Komunë;
 - 3.4 Qendra për Punë Sociale;
 - 3.5 Tryeza multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rasteve;
 - 3.6 Institucionet shëndetësore;
 - 3.8 Institucionet publike dhe private të arsimit parauniversitar;
 - 3.9 Klubet, shoqatat sportive dhe artistike;
 - 3.10 Institucioni I Avokatit të Popullit;
 - 3.11 Këshillat e fshatrave dhe lagjet urbane;
 - 3.12 Shoqatat e prindërve;
 - 3.13 Organizatat e shoqërisë civile;
 - 3.14 Zyrat dhe njësitë e organizatave ndërkombëtare në komunë;
 - 3.15 Organet tjera (formale dhe joformale), që si qëllim parësor kanë promovimin dhe mbrojtjes së përgjithshme sociale dhe mirëqenies së të gjithë fëmijëve.

Neni 6

Mekanizmat koordinues për të drejtat e fëmijës

1. Mekanizmi koordinues komunal, shërben si një platformë apo rrugë për vendosjen e prioriteteve dhe sistemeve të sigurimit të cilësisë për formësimin e çështjeve dhe zgjidhjeve për fëmijë, veçanërisht për vënien në praktikë të angazhimeve dhe veprimeve të politikave ekzistuese.
2. Mekanizmi koordinues komunal krijon një mjedis mundësues për përgatitjen e planeve të veta për zhvillim.
3. Kryetari I Komunës me themelon mekanizmin koordinues komunal për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve.
4. Mekanizmi koordinues përbëhet nga përfaqësuesit e institucioneve të përcaktuara në nenin 5 të kësaj rregullore.

5. Mekanizmi koordinues udhëhiqet nga Drejtori I Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
6. Mekanizmi koordinues do të:
 - 6.1 Promovoj konceptin e komunës mike për fëmijë dhe praktikat e përkufizuara sipas mjeteve dhe udhëzimeve të krijuara;
 - 6.2 Sigurojë koordinimin e politikave të cilat ndikojnë tek fëmijët;
 - 6.3 Sigurojë që aktet nënligjore të nivelit loka të promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e fëmijëve;
 - 6.4 Kryen vetëvlerësime periodike, të cilat me veprime dhe politika që duhet të ndërmerren nga institucionet komunale në mënyrë që të krijohet një komunë mike për fëmijë;
 - 6.5 Udhëheqë procesin e hartimit të strategjisë komunale dhe planit të veprimit për fëmijë në baza periodike dhe të përcjellë zbatimin e tij bazuar në vetëvlerësim komunal;
 - 6.6 Strategjia komunale dhe plani i veprimit për të drejtat e fëmijëve miratohen në Kuvendin e komunës;
 - 6.7 Sigurojë një sistem komunikimi që mundëson rrjedhën dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve komunale dhe njësive specifike të institucioneve relevante, përgjegjëse për çështjet e fëmijëve;
 - 6.8 Bënë rekomandime për të vepruar në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.
7. Mekanizmi koordinues nuk e përjashton krijimin e organeve, ekipeve dhe trupave të tjerë në varësi të këtij mekanizmi, qofshin ato të përkohshme apo të përhershme, të orientuara në aspekte të veçanta të të drejtave të fëmijëve. Megjithatë, kjo e fundit duhet t'i mbajë marrëdhëniet me organet e krijuara, të raportojë mbi punën e tyre dhe të marrë këshilla dhe rekomandime nga mekanizmi koordinues.

Neni 7

Tryeza multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit

1. Tryeza multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rasteve, themelohet në Komunën e Vitisë në nivel profesionistësh sipas legjislacionit në fuqi.
2. Tryeza multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rasteve, udhëhiqet nga menaxheri i rastit, në koordinim dhe bashkëpunim me strukturat dhe shërbimet përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës.

Neni 8

Vlerësimi i ndikimit të fëmijës

1. Komuna zhvillon një proces për vlerësimin e ndikimit të politikave, legjislacionit, strategjive e planeve të veprimit dhe programeve për fëmijë.
2. Ky proces vlerëson situatën e të gjithë fëmijëve me vëmendje të veçantë tek fëmijët nga grupet e cenuara.
3. Sigurohet që vlerësimi i ndikimit tek fëmijët fillon mjaft herët gjatë analizës së situatës dhe formulimit të ndërhyrjeve për të pasur ndikim në vendimmarrje.
4. Kryen një vlerësim të rregullt të ndikimit të aspekteve të qeverisjes lokale tek fëmijët.
5. Sigurohet një hapësirë për procesin e pavarur të vlerësimit në lidhje me ndikimin e politikave në praktikat dhe shërbimet për fëmijë.

Neni 9

Sistemi i raportimit të rregullt mbi gjendjen e fëmijëve

1. Kryetari i Komunës i raporton Kuvendit të Komunës për punën dhe funksionimin e mekanizmit koordinues mbi të drejtat e fëmijëve.
2. Mekanizmi koordinues i përcakton treguesit të dhënat që janë prioritet të komunës për fëmijët dhe interesat e tyre.
3. Komuna i përcakton rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha institucioneve komunale në mbledhjen e të dhënave dhe raportimin nga sektorët përkatës të lidhura me qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Në rast kur komuna nuk ka të dhëna të mjaftueshme, ata janë të obliguar t'i sigurojnë ato në bashkëpunim me nivelin qendror.
4. Komuna e cakton njësinë përgjegjëse në komunë, për të nxjerrë të dhëna të rëndësishme dhe raportim të rregullt mbi statusin e treguesve, të cilët sigurohen nga institucionet përgjegjëse komunale dhe raportohet zyrtarisht në bazë vjetore.
5. Komuna i shfrytëzon në mënyrë efektive raportet për të zhvilluar politika, strategji komunale, plane të veprimit dhe buxhetim për fëmijë, dhe duke u bazuar në nevoja kërkon që njësitë përgjegjëse t'i azhurnojnë të dhënat dhe raportimet në çdo kohë.
6. Bazuar në trendët e zhvillimit komunal, mekanizmi koordinues i shqyrton treguesit dhe raporton periodikisht në mënyrë që t'i rishikojë ato bazuar në nevoja.

Neni 10

Buxhetimi për fëmijë

1. Komuna zhvillon një proces për analizimin e nevojave të buxhetimit për fëmijët e komunës, bazuar në procesin e vlerësimit dhe raportimit. Ky proces përfshinë:
 - 1.1 Identifikimin nëse fëmijët janë duke i pranuar pjesët e duhura të burimeve për investime publike, në shërbime ku shpërndarja administrohet nga niveli I vendit;
 - 1.2 Identifikimi i nevojave për shërbime sociale për fëmijët dhe mbështetja e planifikuar përmes buxhetit komunal;
 - 1.3 Analizën adekuate të buxhetit të përgjithshëm komunal dhe elementet brenda tij, në mënyrë që të përcjellët pjesa që është shpenzuar për fëmijë dhe të shfrytëzohen dëshmitë e gjeneruara për të investuar në fëmijë.

Neni 11

Promovimi i të drejtave të fëmijëve

1. Komuna ndërmerr masa të qarta, në mënyrë që të promovohen dhe respektohen të drejtat e fëmijëve, si nga fëmijët ashtu edhe nga të rriturit.
2. Masat për promovimin e të drejtave të fëmijëve përfshijnë (por nuk kufizohen në):
 - 2.1 Organizimin e trajnimeve mbi të drejtat e fëmijëve për udhëheqësit dhe zyrtarët komunal;
 - 2.2 Përfshirjen e mësimi rreth të drejtave të fëmijëve dhe Konventës për të Drejtat e fëmijëve në kurrikulen me bazë në shkollë;

- 2.3 Përfshirjen e mësimit, promovimit dhe respektimit të të drejtave të fëmijëve, në kuadër të programeve të trajnimit para dhe gjatë shërbimit për persona të cilët punojnë me ose për fëmijë në nivel komunal.
3. Vlerësimin e rregullt të njohurive për të drejtat e fëmijëve në mesin e të rriturve dhe fëmijëve.
4. Promovimin e punës së institucioneve, të cilat e kanë mandate ligjor promovimin, monitorimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.
5. Komuna krijon partneritete me institucionet qendrore, organizatat e shoqërisë civile, grupet e rinjve dhe mediat për t'i promovuar të drejtat e fëmijëve.

Neni 12

Cilësia e shërbimeve për fëmijë në nevojë

1. Komuna ndërmerr masa për ofrimin e shërbimeve cilësore për fëmijët në nevojë sipas legjislacionit në fuqi.
2. Komuna bashkëpunon ngushtë me organizatat e shoqërisë civile të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 13

Avokimi i pavarur për fëmijë

1. Komuna krijon një sistem të qëndrueshëm të partneritetit me organizatat e shoqërisë civile dhe institucione të pavarura, të cilat avokojnë për të drejtat e fëmijëve. Në këtë drejtim, në këtë drejtim:
- 1.1 Organizatave të shoqërisë civile, u jepet mbështetje adekuate për të zhvilluar kapacitetet e tyre për të ndikuar në vendimmarrje në mënyrë të pavarur në fushën e të drejtave të fëmijëve;
- 1.2 Inkurajohen dhe mbështeten organizatat e të rinjve dhe fëmijëve;
- 1.3 Lehtësohet themelimi i institucioneve të pavarura për të drejtat e fëmijëve;
- 1.4 Mbahen komunikime të rregullta me organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet e pavarura në mënyrë që të sigurohet një situatë e qartë e fëmijëve në komunë nga një perspektivë tjetër.
2. Kuvendi i Komunës, organizon të paktën një seancë vjetore për t'i diskutuar çështjet e të drejtave të fëmijës, duke iu referuar raportit të situatës për fëmijë, sipas nenit 9, paragrafi 4 të kësaj rregullore.
3. Komuna organizon "ditët mike për fëmijë" (të paktën 3 ditë në vit) dhe diskuton çështjet lidhur me të drejtat e fëmijës.

Neni 14

Pjesëmarrja e fëmijës

1. Komuna siguron pjesëmarrjen aktive të fëmijëve në rastet me interes për ta në çdo proces vendim-marrës në nivel komune. Të gjithë zyrtarët publik, institucionet dhe njësitë komunale, janë të obliguara ta pasqyrojnë këtë në punën e tyre.
2. Institucionet edukative e mundësojnë mësimin dhe praktikimin e pjesëmarrjes aktive përmes kurrikulës së shkollës dhe aktiviteteve ekstra-kurrikulare dhe në koordinim me institucionet e

sektorëve përkatës të cilët janë në kontakt të drejtpërdrejtë me fëmijët gjatë ofrimit të shërbimeve për ta (shëndetësia, mirëqenia sociale, arsimi, etj).

3. Institucionet edukative kulturore dhe sportive, nxisin krijimin dhe funksionimin e organizatave të fëmijëve dhe të rinjve.

4. Organet administrative në komunë, në rastin e vendimmarrjes për rastet që ndikojnë tek fëmijët, i marrin plotësisht parasysh pikëpamjet e fëmijëve dhe në përputhje me praktikat dhe udhëzimet e përcaktuara nga legjislacioni ekzistues dhe i përshtatshëm për moshën e tyre.

5. Pjesëmarrja kuptimplot e fëmijëve sigurohet në procesin e vlerësimit të ndikimit të ligjeve, politikave dhe praktikave tek fëmijët në procesin e raportimit për gjendjen e fëmijëve në komunë, në procesin e buxhetimit për fëmijë si dhe në promovimin e të drejtave të fëmijëve.

6. Në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrja e fëmijëve, komuna e merr parasysh dhe bashkëvepron rregullisht me Asamblenë Komunale të Fëmijëve, si organ primar që i përfaqëson në mënyrë të drejtpërdrejtë opinionet dhe pozitën e të gjithë fëmijëve, në veçanti të atyre më të cenuarve.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 15

Procedurat për zbatimin e Rregullores

1. Mekanizmi koordinues e monitoron zbatimin e kësaj rregullore dhe harton raporte vjetore për nivelin e zbatimit të saj.

2. Kuvendi i Komunës shqyrton dhe miraton raportin vjetor të mekanizmit koordinues për nivelin e zbatimit të rregullores dhe në rast të mos zbatimit të saj merr vendime për masat eventuale për sigurimin e zbatimit të saj të plotë.

3. Në rast të mos përmbushjes së detyrave lidhur me zbatimin e Rregullores nga zyrtarë publik, organet përkatëse komunale marrin masa adekuate në pajtim me procedurat komunale.

4. Kryetari i Komunës, brenda tre (3) muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregullore, nxjerr vendimet e parapara sipas Nenit 5, paragrafi 3 si dhe Nenit 9, paragrafi 3 për zbatimin e saj.

Neni 16

Hyrja në fuqi


Kjo rregullore hyn në fuqi, 15 ditë pas rexhistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Qershor, 2019





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58, shkronja h) e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 13 i Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2018 për Transparencën në Komuna, neni 7 i Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2018, për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, neni 50.1, shkronja l) të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shpalljen në diskutim publik për propozimin rregulloren për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së subjekteve të biznesit në Komunën e Vitisë

Neni 1

Kryetari i Komunës, i propozon Kuvendit të Komunës së Vitisë, që të shpallë në diskutim publik propozim rregullorë për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së subjekteve të biznesit në Komunën e Vitisë

Neni 2

Propozimi në diskutim publik i propozim rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së subjekteve të biznesit në Komunën e Vitisë do të jepet në diskutim publik deri me: 09.08.2019.

Neni 3

Debati publik do të mbahet me datën: 12.08.2019 në ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Neni 4

Të drejtë pjesëmarrje në diskutim publik kanë të gjithë qytetarët e interesuar, organet dhe institucionet e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Qëllimi i këtij diskutimi publik është për të krijuar opinione pozitive për propozim rregullorë për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së subjekteve të biznesit në Komunën e Vitisë

Neni 6

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Propozues:

Kryetari i Komunës, Sokol Haliti





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo
Vitina



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of

PROPOZIM RREGULLORE PËR

**FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS SË SUBJEKTEVE TË BIZNESIT
NË KOMUNËN E VITISË**

Viti, Qershor 2019

Në bazë të nenit 58, paragrafi 1, pika h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nenit 50, paragrafi 1, pika 1 të Statutit të Komunës së Vitisë Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, kryetari i Komunës paraqet këtë:

PROPOZIM RREGULLOREN

PËR

FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS SË SUBJEKTEVE TË BIZNESIT NË KOMUNËN E VITISË

I.DISPOZITAT E PËRGJTHSHME

Qëllimi

Neni 1

Me këtë Rregullore, përcaktohet fillimi dhe mbarimi i orarit të punës në lëmin e tregtisë dhe të aktiviteteve tjera, si: hoteleri, zejtari dhe shërbime tjera të organizimit në territorin e Komunës së Vitisë.

Neni 2

Subjektet e biznesit, në pajtim me nenin 1 të kësaj Rregulloreje, janë të obliguara t'i përmbahen orarit të punës të përcaktuar me këtë Rregullore.

Neni 3

3.1 Orari i punës nënkupton periudhën kohore, fillimin dhe mbarimin e punës.

3.2 Orari për fillimin dhe mbarimin e punës, i përcaktuar me këtë Rregullore, duhet të vendoset në hyrje apo në vend të dukshëm të objektit në të cilin kryhet veprimtaria e biznesit. Në orar të punës duhet cekur ditët kur nuk punohet.

II PËRKUFIZIMET

II.1 Fjalët dhe shprehje e përdorura në këtë Rregullore në vijim:

II.1.1 Lokale Afariste – nënkupton objektin apo hapësirën punuese, shërbyese, ku ushtrohet ndonjë veprimtari afariste.

II.1.2 Person juridik – nënkupton drejtorin apo përgjegjës të subjektit të biznesit, shoqëritë aksionare, shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, ndërmarrjet publike, organizatën dhe asociacionin tjetër të regjistruar.

II.1.3 Person fizik – nënkupton individin ose personin fizik si pronari i ndërmarrjes së regjistruar si biznes individual.

II.1.4 Inspektor - personi zyrtar me autorizime dhe përgjegjësi të veçantë, i cili zbaton mbikëqyrjen inspektuese të afarizmit të subjekteve të biznesit.

II.1.5 Periudha verore – nënkupton periudhën e vitit prej 01.04.derishtë 31.10. të vitit përkatës.

II.1.6 Periudha dimërore – nënkupton periudhën prej 01.11 derishtë 30.03. të vitit përkatës.

II.1.7 Fundjavë – nënkupton periudhën prej të Premtes në mbrëmje, të shtunën dhe dielën.

II.1.8 Festa Zyrtare – ditët e festive sipas ligjit mbi festat zyrtare .

III. ORARI I PUNËS

Neni 4

4.1 Orari i punës përcaktohet në bazë të llogaritjes verore dhe dimërore, në intervale kohore:

4.1.1 Periudha verore fillon më 1 prill dhe mbaron më 30 shtator të vitit;

4.1.2 Periudha dimërore fillon më 1 tetor dhe mbaron më 31 mars të vitit.

Neni 5

5.1. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës në Veprimtari zejtare:

5.1.1 Periudha verore, prej orës 8:00 derishtë në orën 20:00;

5.1.2 Periudha dimërore, prej orës 8:00 derishtë në orën 19:00; dhe

5.1.3 Të dielave nuk punojnë.

5.2. Gjellëtoret dhe qebaptoret punojnë çdo ditë pune:

5.2.1 Periudha verore, prej orës 6:00 - 23:00;

5.2.2 Periudha dimërore prej orës 7:00 - 23:00.

5.3. Ditën e fundjavës (të dielën) dyqanet zejtare nuk do të punojnë, përveç: furrat e bukës, gjellëtoreve, qebaptoreve, salloneve të ondulimit, floktoreve, autolarjeve.

Neni 6

6.1. Orari i punës në vetëshërbime, supermarketet dhe dyqane ushqimore, do të jetë:

6.1.1 Periudha verore, prej orës 7:00 – 23:00;

6.1.2 Periudha dimërore, prej orës 8:00 – 23:00;

6.1.3 Të dielave nuk punojnë.

6.2. Orari i punës në dyqanet tregtare të tekstilit, dyqanet e këpucëve, dyqanet e pajisjeve teknike shtëpiake “teknikës së bardhë” dhe veprimtarive të tjera jo ushqimore, do të jetë:

6.2.1 Periudha verore, prej orës 7:00 – 21:00;

6.2.2 Periudha dimërore, prej orës 8:00 - 20:00.

6.3. Barnatoret Farmaceutike, ordinancat private mjekësore do të punojnë:

6.3.1 Periudha verore, prej orës 7:00 – 24:00;

6.3.2 Periudha dimërore, prej orës 8:00 - 23:00;

6.3.3 Të dielave nuk punojnë, përveç barnatoreve që janë kujdestare për atë të diele;

6.3.4 Barnatoret farmaceutike private, të cilat operojnë në qytetin e Vitisë, mund të operojnë edhe pas këtij orari të përcaktuar nëse kërkesat dhe nevoja e tregon. Këto barnatore janë të obliguara të mbajnë kujdestari dhe atë së paku nga një barnatore. Orarin e kujdestarisë do të hartojnë vetë barnatoret farmaceutike dhe do të dorëzohet tek Drejtoria për Inspeksion dhe i njëjti orar do të jete i shpallur në ambientet e QKMF-së së Vitisë, nga ku qytetarët do t'i marrin informatat e nevojshme. Orari i kujdestarisë do të caktohet sipas alfabetit. Nëse barnatoret së bashku me SHFK-në apo shoqatën e tyre, nuk e caktojnë orarin e kujdestarisë, të njëjtin do ta bëjë Inspektorati, dhe si tillë duhet të respektohet.

6.4 Barnatoret bujqësore do të punojnë:

6.4.1 Prej orës 8.00 deri më 18.h;

6.4.2 Përjashtimisht jashtë këtij orari mund të punojnë në sezonën e mbjelljeve, korrjesirjeve si dhe ditëve të vikendit;

6.4.1 Të dielave nuk punojnë.

Neni 7

7.1. Orari i punës në depot e artikujve ushqimorë, depot e materialit ndërtimor dhe në ndërmarrjet që merren me prodhimin e betonit, do të jetë:

7.1.1 Periudha verore, prej orës 8:00 - 20:00;

7.1.2 Periudha dimërore, prej orës 8:00 - 18:00;

7.1.3 Ditën e fundjavës (të dielën) dhe gjatë ditëve të festave, depot nuk punojnë.

7.2. Orari i punës në ndërmarrjet ndërtimore (ndërtimi i ulët dhe i lartë), do të jetë:

7.2.1 Periudha verore, prej orës 7:00 - 18:00;

7.2.2 Periudha dimërore, prej orës 8:00 - 17:00;

7.2.3 Ditën e fundjavës (të dielën), ndërtimi nuk punojnë;

7.2.4 Ndërmarrjet ndërtimore, në raste të jashtëzakonshme, për shkak të natyrës së punëve, mund të punojnë me orar të zgjatur deri në orën 23:00 me leje të posaçme të cilën e lëshon Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim..

7.3 Bizneset prodhuese orari i punës:

7.3.1 Nuk kane kufizimi dhe mund të punojnë deri sa nuk bien në kundërshtim me Ligjin mbi Zhurmën.

Neni 8

8.1 Orari i punës në kafene do të jetë:

8.1.1 Periudha verore, prej orës 7:00 – 24:00;

8.1.2 Periudha dimërore, prej orës 08:00 – 23:00.

8.2. Orari i punës në hotele, motele dhe restorante:

8.2.1 Në të dy sezonet fillon prej orës 7:00 - 24:00.

8.3. Përjashtim nga pika 2 e këtij neni do të ketë, sepse mund të punojnë më gjatë se orari i paraparë i punës, por jo më shumë se deri në orën 3:00 të mëngjesit. Për këtë duhet të kërkohet leje e veçantë, të cilën e lëshon Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim. Për vazhdimin e orarit të punës duhet paguar taksën shtesë, 10 € për orë pune.

8.4. Veprimtarive të lartpërmendura në piken 2 të këtij neni, nuk iu lejohet shërbimi për mysafirë jashtë objektit pas orës 24:00.

Neni 9

9.1. Orari i punës në kafe - bare dhe diskoklube, është i njëjtë për të dy sezonet, fillon në orën 20:00 dhe mbaron në orën 3:00 (të mëngjesit).

9.2. Orari i punës për klubet e natës është i njëjtë në të dy sezonet, fillon prej orës 23:00 dhe mbaron në orën 5:00 (të mëngjesit).

9.3. Orari i punës për internet - kafe dhe bastore fillon në orën 8:00 dhe mbaron në orën 23:00.

Neni 10

10.1 Pikat e shitjes së derivateve të naftës, mund të punojnë pandërprerë në dy periudhat e llogaritjes së kohës sipas sezoneve.

10.2 Restorantet, kafiterit, shitoret ushqimore, që janë nën menaxhimin e pikave të shitjes së karburanteve, mund të punojnë deri në ora 24.00 h, dhe mund të zgjasin orarin e punës deri në ora 02.00 h, me kusht që të kenë lejen përkatëse për zgjatje të orarit të punës.

Neni 11

11.1 Stadiumet e improvizuara të futbollit dhe palestrat sportive punojnë pa kufizime.

11.2 Orar i punës për pishina të hapura është nga ora 10 h deri në ora 20.00 h.

11.3 Orari i punës për organizimet e ndërmarra nga Organizatat Joqeveritare (OJQ), subjektet fetare, subjektet politike, ndonjë institucion apo të ngjashme, mund të zgjatet orari deri në orën 02.00h, vetëm nëse aktiviteti ka qëllim kulturorë, social, humanitar apo të ngjashme. Në këto rrethana zgjatja e orarit të aktiviteteve mund të behët pa leje përkatëse dhe pa pagesë të taksës për zgjatje të orarit të aktivitetit, por vetëm me njoftim tek organet e rendit dhe sigurisë publike.

Neni 12

Veprimtarive të parapara në nenet 8, 9 dhe 10 të kësaj Rregulloreje, gjatë orarit të punës nuk iu lejohet t'u prishin qetësinë qytetarëve që banojnë në afërsi të lokaleve ku ushtrohet veprimtaria. Gjithmonë duke u bazuar në Ligjin për Siguri Publike dhe Ligjin për Mbrojtje nga Zhurma.

Neni 13

12.1. Orari i punës për tregjet e qytetit dhe tregjet e lokaliteteve është:

12.1.1 Periudha verore, prej orës 6:00 – 19:00;

12.1.2 Periudha dimërore, prej orës 7:00 – 18:00.

12.2. Tregu i gjelbër do të punojë gjatë të Mërkurës në Pozheran dhe gjatë të Enjtes në Viti.

12.3. Tregu i kafshëve punon të Mërkurën në Pozheran dhe të Enjten në Viti.

Neni 14

Orari i punës në pikat e shitjes së karburanteve është i njëjtë në të dy sezonet, fillon prej orës 00:00 dhe zgjatë deri në orën 24:00 (pa ndërprerë).

Neni 15

15.1. Orari i punës në ordinanca dhe klinika private, do të jetë i njëjtë në të dy sezonet, fillon në orës 7:00 dhe mbaron në orën 22:00.

15.2. Në raste urgjente, të dielave dhe gjatë festave shtetërore, mund të punojnë edhe jashtë orarit të paraparë sipas paragrafit 15.1.

Neni 15

15.1 Për vazhdimin e orarit të punës duhet paguar taksën shtesë, dhe atë:

15.1.1 Taksa për zgjatje të orarit, për një natë 10 €;

15.1.2 Taksa për zgjatje mujore, për një muaj 100 €.

Neni 16

16.1 Zgjatja e orarit të punës:

16.1.1 Për zgjatje të orarit të punës subjektet e biznesit duhet të parashtrojnë kërkesë 48 orë më parë në ditët zyrtare të punës.

16.1.2 Kriteret dhe dokumentet e nevojshme për aplikim për zgjatje të orarit të punës janë:

- a) Plotësimi i formularit për zgjatje të orarit të punës;
- b) Certifikata e biznesit (kopje);
- c) Lejenjoftimi i pronarit të biznesit ose personit të autorizuar (kopje);
- d) Pëlqimi për plotësimin e kushteve minimale teknike, sanitaro-higjieneike për ushtrimin e veprimtarisë biznesore nga inspeksioni i tregut dhe ai sanitarë (kopje);
- e) Pagesa e taksës për zgjatje të orarit të punës, varësisht nga tarifa e përcaktuar sipas nenit.
- f) Drejtoria në raste të veçanta, mbanë të drejtën e kërimit të dokumenteve shtesë sipas nevojës apo rastit konkret.

Neni 17

Çdo dhënie pëlqimi për zgjatje të orarit të punës, Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, një kopje të pëlqimit duhet ta dërgoj tek Drejtoria për Inspeksion dhe Shërbimit Policor të Kosovës – Stacionit në Viti.

Neni 18

18.1. Organizatat e biznesit mund ta zgjasin orarin e punës me rastin e festave, të parapara me Ligjin për Festat Zyrtare, deri në orën 2:00 (të mëngjesit).

18.2. Për të gjitha rastet e parapara në piken 1 të këtij neni, nuk paguhet taksa shtesë.

III. DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 19

Të gjitha organizatat e biznesit do të gjobiten për kundërvajtje, në qoftë se veprojnë në kundërshtim me nenet 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18 të kësaj Rregulloreje, si më poshtë:

a. persona juridik 200 - 400 €

b. persona fizik 100 - 200 €.

Neni 20

Të gjitha organizatat e biznesit të cilat marrin leje për orar të zgjatur të punës, nëse nuk e përfillin kodin afarist dhe rrezikojnë sigurinë e qytetarëve, do t'u merret leja e punës e lëshuar nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

IV. DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 21

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdeset Sektori i Inspeksionit të tregut, Policia e Kosovës dhe Gjykata për Kundërvajtje.

Neni 22

Të gjitha organizatat e biznesit, janë të obliguara që të harmonizojnë orarin e punës me dispozitat e kësaj Rregulloreje, në afatin tridhjetë (30) ditësh nga dita e hyrjes së kësaj Rregulloreje në fuqi.

Neni 23

Ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet të gjitha rregulloret që kanë të bëjnë me fillimin dhe mbarimin e orarit të punës.

Neni 24

Kjo propozim rregullore hyn në fuqi 15 ditë nga data e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës.

Viti, Qershor 2019

Kryetari i Komunës
Sokol HALITI





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 40 paragrafi 2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, nenit 35 paragrafi 2 pika d), të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryesuesi i Komunës së Vitisë, paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM

PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT VJETOR TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2020

Neni 1.

Me këtë propozim vendim, Kryesuesi i Kuvendit Komunal i PROPOZON Kuvendit të Komunës së Vitisë që të bënë themelimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetori të punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2020.

Komisioni për bëhet nga këta anëtar:

- | | |
|--------------------|---------------------------------|
| 1. Naim Pira | Kryesuesi i Kuvendit Komunal |
| 2. Ali Bajrami | Shefi i GP- të LDK-së |
| 3. Mirlinda Sadiku | Shefi i GP- të VV-së |
| 4. Bekim Azizi | Shef i GP- të PDK-së |
| 5. Vehbi Rama | Shefi i GP-të AAK-së |
| 6. Fatlum Demiri | Sekretaria e Kuvendit |
| 7. _____ | Përfaqësues nga shoqëria civile |

Neni 2.

Grupi punues konform nenit 1 të këtij propozim vendimi, në konsultim me kryetarin e Komunës, drejtorët e Drejtorive komunale, subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend dhe shoqërinë civile, harton Draftin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin kalendarik 2020 dhe të njëjtin e paraqet para Kuvendit të Komunës për miratim.

Neni 3.

Plani vjetor i punës së Kuvendit duhet të përmbajë: objektivat dhe qëllimet e kuvendit, aktivitetet e planifikuara të Kuvendit dhe Komiteteve obligative dhe funksionale të Kuvendit, afatet e përmbushjes dhe realizimin e aktiviteteve të parapara si dhe koston financiare për implementimin e Planit të punës.

Neni 4.

Plani i punës së Kuvendit mund të ndryshohet dhe plotësohet nga ana e Kuvendit sa herë që kjo të jetë e nevojshme.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë.

Neni 6

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Pira

